



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## **PROCESVERBAL**

### **I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË**

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 31.01.2019 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndërsa munguan Vehbi Rama, Vjollca Kadolli-Halili, Rufadije Halimi-Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI-së përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Barazi Gjinore, zyrtarë nga zyre tjera dhe mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, kryetarin, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtoj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

**z.Njazi Isaku:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht këtu më duket se paska edhe medja, besoj se çështja e mediave është rregulluar.

**Kryesuesi Naim Pira:** Sa për informimit, tash Zyra për Informim më njoftoi, se procedurat paskan përfunduar, ka mbetur vetëm nënshkrimi I marrëveshjes. Më duket se RTI-ja e ka fituar me bë përcjelljen e seancave të kuvendit. sidoqoftë unë e falënderoj *Plus Televizionin* për prezencën e tyre dhe përcjelljen e seancave.

**z.Njazi Isaku:** D.m.th edhe pas 6 muajve nuk kemi media për përcjelljen e seancave. Kjo është fatkeqësi. Kur I pash, unë mendova me ju uru që pas sa kohe është arritur një kontratë për media, mirëpo edhe kjo mbledhje po shkon kështu, kur dihet se është një mbledhje me rëndësi, është edhe informata e kryetarit edhe ne si asamblist ku nuk mundemi mi shfaq këto ankesa në Kuvend, kur nuk ka media, s’di ku mundemi tjetër kund me i shpalos këto. Po sido që të jetë, po kaloj te pyetjet, ka lidhje me pastrimin e rrugëve nga bora. Kjo është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, meqenëse është në domenin e saj. A keni pasur plan të punës për mirëmbajtjen e rrugëve? Kur jemi të gjithë dëshmitarë, se si janë mirëmbajtur këto rrugë. Këto ditë në komunën tonë kemi pasur dy reshje të mëdha të borës, njëra me 16 dhjetor dhe tjetra me 10 janar, ku besoj se të gjithë e kemi par se si janë mbajtur rrugët si në qytet po ashtu edhe nëpër fshatra, ku një pjesë e madhe e fshatrave janë pastruar nga vullnetaret e

atyre fshatrave, e mos të flasim për tretarët se në çfarë gjendje kanë qenë. Ato janë pastruar nga bora vetëm pasi është shkëputur bora. Komuna ka nënshkruar një kontratë e cila është operator ekonomik me datën 01.08.2018 për mirëmbajtje të rrugëve në vlerë prej 55 mijë euro. A ka menaxher që e mbikëqyrë këtë kontratë, ku operatori ekonomik e ka për obligim mirëmbajtjen e rrugëve, e ky menaxher I kontratës e ka përgjegjësi me mbikëqyrë zbatimin e kontratës së nënshkruar, se në fund janë parat e taksapagueseve të kësaj komune dhe çfarë shërbimi po ju ofron kjo kompani. Pyetje, a keni marrë ndonjë masë ndëshkimore ndaj kësaj kompanie, ku ka shfaqur një papërgjegjshmëri lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve në komunën tonë, apo kjo tani më është e harruar me shkëputjen e bores?

**z.Nuredin Lutfiu:** Kam një pyetje për drejtoreshën e Kadastrit. Më intereson të di rreth një propozim vendimi lidhur me kërkesën për shndërrimin e pronës nga AKP-ja në pronë publike me interes të përgjithshëm dhe një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Drejtor, është hera e katërt që e ngriti një çështje për rrugën “14 Qershori” në Viti në mes të rrugës, pas çdo reshje bëhet një pusët më intereson ta di, se a do të rregullohet ajo rrugë dhe kur dhe kam një falënderim rrethë ndërtimit të ambulantes në fshatin Skifteraj, në emër të banorëve falënderoj mërgatën e këtij lokaliteti dhe qeverisjen lokale në krye me z.Sokol Haliti për ndihmën e dhënë lidhur me këtë projekt. Duhet të ceket, se gjatë hapjes solemne të kësaj ambulante nga drejtoresha e QKMF-së, është premtuar se do të vizitohet ambulanten një mjek një here në javë, shpresoj të mbahet ky premtim.

**z.Bekim Azizi:** Uroj për një vit të mbarë, pasi është seancë e parë për këtë vit. Meqenëse sot është edhe raporti I kryetarit, kjo pikë e parë mund me na lidh me shumë gjëra që mund t’i diskutojmë, edhe në atë pikë do të jem pak ma i shkurtër. Kisha ba një pyetje te tregu I kafshëve, pse që dy vite është investuar në të, është gati atje, është problematik, se bëhet edhe bllokimi I rrugës magjistrale dhe është punuar në të, është investuar në të dhe nuk është larguar në vendin ku është miratuar nga kuvendi, pse është duke ndodhur kjo? Dhe kisha pas një kërkesë për këtë vit. Në rrugët rurale që do të shtrohen në Smirë, te varrezat te “Laqtë”, deri te vendi I ramjes së tre dëshmoreve, nuk është mbi 200 metra, duhet të bëhet asfaltimi atje.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Pata bërë pyetje drejtoreshës së Arsimit, në lidhje me mësimin joformal. Përgjigja që më është dhënë për vitin 2013, që kanë mbetur borxh profesorëve, me pate thanë se do ta shikojmë mundësitë financiare dhe ligjore, a ka lëvizje diçka në atë drejtim si dhe po ashtu pata bërë pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë për vendimin e qeverisë në lidhje me vendimin që është ndihmë fermerëve që kanë pasur dëme në kulturat e tyre bujqësore, a ka lëvizje diçka në atë drejtim, ku e kam parë se Mamushes vetëm se ju kanë ndarë gjysmë milioni euro.

**znj.Gjylsime Qamili:** Kam një pyetje për drejtorin e Inspeksionit. Në raportin 6-mujor, drejtor, e kam par një kërkesë për çerdhe fëmijësh në shqyrtim e sipër, a ke mundësi të na tregosh për kënd bëhet fjalë dhe a është shqyrtuar kjo kërkesë, pasi që në raportin I vjeçar, tash veç nuk e pash që po figuron kjo kërkesë.

**znj. Blerina Lubishtani:** Një pyetje për drejtorin e Inspeksionit. Drejtor, në raport thuhet se keni asgjësuar mbi 22500 kg mallra ushqimore, qa keni ndërmarr me këto raste, a I keni sanksionuar dhe si I keni asgjësuar këto produkte ushqimore.

**znj. Hidajete Pira:** Kërkesë e banoreve të Pozheranit si dhe fshatrave për rreth, është hapja e Njësitit të Zjarfikësve në Pozheran, pasi që mendoj se I plotëson kushtet edhe për nga numri I banorëve edhe intervenimet kishin me qenë ma të shpejta.

**z.Rasim Terziu:** Unë kam një problem që e kam parashtruar edhe shumë herë të tjera te drejtori I Shërbimeve Publike rreth ujësjellësit në Pozheran. Ka probleme të mëdha me ujësjellës, le që ka ndërprerje, por edhe uji është në nivelin ma të keq. E dyta, është se, p.sh. në formën paushallë kur të inkasohet mjetet inkasohen 16,50 euro që është një shumë ma merr mendja e madhe, tu I krahasu me qytetet tjera. P.sh. në Ferizaj ujin e paguaj 6 euro dhe uji është shumë ma kualitet se në Pozheran. Kem një ankesë shembull të një qytetarit të Pozheranit, ku ju ka faturu për një muj ujësjellësi 215 euro. Ka bërë ankesë, 20 herë ka shkuar, nuk e merr kush parasys. Ka edhe iks raste tjera si rasti I këtij qytetari. Ftoj drejtorin e Shërbimeve Publike për me u angazhua për këtë problem, se shumë qytetar të Pozheranit janë duke u ballafaquar me këso probleme.

**z.Taulant Haxhiu:** Pikë së pari kërkoj nga kryetari që mediat të jenë në çdo seancë, ti bani punët e mira që mediat t'i shohin edhe punët e juaja të mira. Unë jam bërë pak I tepërt, sa here që po dal në foltore për kontratat mbi vepër, ju kam thanë një herë dhe po ju thamë prapë, unë kur ja filloj një punë, dua deri në fund me I shkua kontratat mbi vepër mi keni sjellë vetëm emrat mbiemrat o kryetar mua më duhet sa I kanë kushtuar buxhetit të Komunës së Vitisë ata persona që janë në kontratë mbi vepër, sa është dëmtuar qytetari i Komunës së Vitisë, mua ajo më intereson, se komuna është e qytetareve, komuna nuk është as e imja as e jotja. Këtu mi kanë pruar vetëm kontratat a sa kanë kushtuar dhe sa I kushtojnë buxhetit të Vitisë nuk kam asgjë, kam vetëm emër dhe mbiemër. Edhe ata qa punojnë me një zyre janë 6-7 veta, janë kanë njerëz partiak dhe hajt ti shtiem në punë të ja vazhdomi një kontratë. Mua më duhet me ditë qa punon ai, në sa ja fillon punës, çfarë pune bënë, të jeni pak ma vigjilent edhe të jeni pak ma të sinqertë. Në seancë tjetër e dua për çdo person, sa paguhet edhe çfarë pune kryen.

**z.Jakup Demiri:** Kam një pyetje për kryetarin. Te puna e dy rrugëve që janë shtruar së fundi, rruga te xhamia edhe rruga për Pozheran, cilësia e punimeve aty është jashtë çdo standardi. Besoj se aty e ka pa edhe vetë kryetari çfarë punë janë bërë aty. Besoj se pajtohet edhe ky me neve, se punimet janë bërë jashtëzakonisht të dobëta, ngase gjatë vitit 2017 -2018 për asfaltimin e rrugëve dhe të fushave sportive, kemi pas ankesa edhe nga qytetaret, tu e përfshi rrugën Drobesh që lidhet nga varrezat e dëshmoreve me fshatin Drobesh, mandej një rrugë lagjore në Lubishtë, fusha e sportit në Germovë, dhe këtu faqe 24 te raporti I kryetarit pika 18, te asetet, hartimi dhe mbikëqyrja e projekteve, figuron se 40831 euro janë dhanë për mbikëqyrje të punimeve. Kryetar, a ke ndërmarr diçka rreth tyre sidomos për rrugën e Pozheranit, a është ankuar Komuna, a ju janë nënshkruar asaj kompanie punët që I ka kryer aty. Unë po mendoj a është e pranuar teknikisht ajo rrugë edhe a keni ndërmend me ndryshu qasjen, a do të vezhdoni kështu, se gjitha rrugët që janë shtruar nuk janë kryer punët mirë.

**znj.Liridona Bislimi:** Pasi që është seanca e parë e këtij viti, ju dëshiroj të gjithëve suksese. Sa I përket pyetjeve, desha ta di a është bërë zgjidhja e transportit për nxënësit në fshatit Debellde, pasi që gjysmëvjetori i parë tash më ka kaluar dhe prindërit në mënyra të ndryshme janë munduar me bë zgjidhje. Besoj se gjysmëvjetori I dytë shumë shpejtë do të filloj. Më intereson ta di, a do të kenë transportin e premtuar nga kryetari, Sokol Haliti këta nxënës? Gjithashtu drejtoreshës së Arsimit, desha të ja rikujtoj, se në fund të vjeshtës ka qenë në fshatin Debellde dhe ka thanë, se do të bëhet transporti I nxënësve, mirëpo në planin e prokurimit që e kemi marrë ne, thuhet se transporti I nxënësve do të bëhet për Stubëll, Letnicë, Potgorcë, Viti, Samakovë-Viti. Transporti I nxënësve me nevoja të veçanta, por nuk figurojnë ata të fshatit Debellde, si qëndron puna Kryetar? Tash jemi në legjislacionin e dytë, viti dytë, desha të di kur do të bartemi te komuna e re, e cila sipas kryetarit tonë, tash e disa vite veç se ka qenë pothuajse në përfundim. Gjithashtu në fshatin Drobesh, desha ta di, kur fillon ndriçimi dhe ndërtimi I trotuareve në rrugën kryesore, e cila tash e 5 vite janë premtuar, kemi parë se në fshatrat fqinjë, si në Sadovinë dhe në Germovë, kjo gjë është bërë duke marr parasysh faktin, se kjo rrugë është magjistrale dhe ka komunikacion të dendur. Ju kisha lutur urgjentisht të vendosen shenja të komunikacionit si dhe ato për ndaljen e autobusëve. Gjithashtu te kjo rrugë që është bërë kërkesë nga unë, gjatë gjithë këtij viti që kaloj por edhe legjislacionit të kaluar, gjatë 4 viteve, nga axhi im, Bislim Bislimaj, është kërkesë për nënkallim. Vlen ta cekim, se në ligjislaturen e kaluar është votuar një plan I mobili tetit për qytetin e Vitisë, ku në këtë plane është rekomanduar dhe votuar, që në fshatin Drobesh të ndërtohet një ishull qendror në rrugën kryesore. Në dy anët e vendkalimit të këmbësorëve, për shkak të rrezikut të madh që paraqet kjo rrugë, më intereson ta di pse nuk është ndërmarr ende asgjë, sepse çështja është aq shqetësuese që ka arritur të përmendet edhe këtu gjatë katër viteve në organin ma të lartë të Komunës.

**z.Remzi Salihu:** Pasi që duhet të ju përmbahemi rendit, po shkoj edhe unë vetëm me dy pyetje. E para është për drejtorin e Shërbimeve Publike, vendosja e dritave në fshatin Remnik, si projekt a është I përfunduar, një shpjegim nëse ka mundësi me ma dhanë, nëse këtë seancë nuk mundet, mund ta sjellin në seancë tjetër. Pse me një vend ku ka pasur drita aty, janë ndërruar ku ka pas mundësi që ato drita të vendosen me një krah tjetër? Te pyetja e dytë, është për kryetarin. Siç e dini kryetar, rrugë fushore janë shtruar me zhavorr, në një seance kam ngrit zërin që ato rrugë nuk janë punuar ashtu si duhet dhe si përgjegjësi e keni marr ju, se ato janë me afat

dyvjeçar dhe brenda atij afati do të sanohen që janë bërë aty parregullsitë, mirëpo megjithatë afati dyvjeçar ka kaluar dhe aty nuk është ndërmarr asgjë, edhe në kuadër të kësaj pyetje edhe një kërkesë, që në ato dy rrugë të ndërtohen edhe dy ura. Nuk janë ura të mëdhaja, por me gypa. Çfarë janë vendosur në njëren pjesë dhe në pjesën tjetër nuk janë vendosur fare, nuk keni bërë zgjidhje të duhur.

**z.Sejdi Emini:** Nuk është hera parë që po flitet për shtëpinë e shëndetit, ku prej orës 15:00 deri në ora 08:00 të nesërmen, vetëm me një mjek punohet. Mua më ka rastisur me shkua dhe me pa, është e pa papërballueshme gjendja me qenë vetëm me një mjek, ku një mjeku I bie diku deri në 150 pacient me I kontrollua. Unë mendoj se është e domosdoshme që me qenë edhe një mjek për me përballua situatën dhe gjendjen në të cilën është, p.sh. është një aksident ku mundemi me pas 2/3 të lënduar, cilit mi dhanë ndihmë përpara. Daktoreshë, mendoj se kam të drejtë plotësisht. Tjetra, dua ta bëjë edhe një pyetje konkrete lidhur me ambulanten e fshatit Goshicë. Kryetar, tash jemi në vitin 2019, dua ta di unë dhe qytetarët në Gushicë, se cili është plani, a do ta rregulloni, a do ta ndërtoni apo do ta renovoni ambulanten në të cilën gjendet. Ajo ambulante ka shërbye për të gjithë fshatrat edhe në kohët ma të vështira. Nëse nuk i keni mundësitë tregoni, se janë të gatshëm edhe vet fshati mi bë dy dhoma edhe një korridor edhe me funksionalizu, mirëpo është përgjegjësi dhe kompetencë e juaja. Në mandatin e kaluar, ka pas thanë që qeveria e kaluar e ka një kambë në dhe një përmbi dhe. Unë mendoj se jemi pikërisht në atë gjendje edhe sot, e kam fjalën për kyqjën e autostradës. Çka do të ju themi qytetarëve na nëse dështon kjo qeveri dhe nuk bëhet autostrada, a kemi me mbajt përgjegjësi të gjithë. Herën e kaluar kryesuesi ka thanë dil protesto, askush nuk të ndal, por unë mendoj që as unë as ky vet s'mund të bëj asgjë, të gjithë bashkë me një presion, me një ndërjegje, me një përgjegjësi kemi mund me bë shumë ma shumë se këtu ku jemi. U përmend për pastrimin e rrugëve ma herët. Unë mendoj se qetu në Viti trotuaret munden shumë letë me u pastruar. Qysh munden, p.sh. shumë kultivatorë po jepni si donacion, nalne bre nja për vete me atë koltivator këta punëtorë që janë shumë letë I pastrojnë këto trotuare. Edhe me ble me buxhet të komunës nuk kushton shumë. Kryetar, e kam edhe një kërkesë nga banorët e fshatit Gushicë, e kemi përmend edhe ma herët, rruga e arave, janë diku 20 shtëpi, kanë mbetur begi në pozitë të papërshtatshme, ata kërkojnë që sa ma shpejtë me u shtruar edhe rruga e tyre, se kanë mbetur pak keq dhe porosinë e kam që kërkojnë me qenë edhe ata pjesë e shoqërisë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi u shtrua një numër i madh i pyetjeve. Kisha lutë edhe kryetarin edhe drejtorët, që mundësisht të japin përgjigje.

**Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti:** Të nderuar Këshilltar të kuvendit komunal, qoftë I mbarë ky vit, të na hecë mbarë me punë bashkërisht. Ju falënderoj për pyetje këshilltar të gjithëve, për temat që ngritët, edhe se përnjëmend këtë piktë të rendit të ditës e kemi shndërruar në debat. Tash vetëm Sejda I bëri 5 pyetje, tash këtij unë mundem me ju përgjigj, mirëpo I ngriti 5 çështje të mëdha, si tema e ambulantes në Goshicë, nuk është temë e vogël, për shkak se ata e ka djegë dikush, prandaj ka procedura, duhet me na ardhur procesi. Na punojmë institucionalisht, se njëherë duhet me ditë kush e ka djegë, a u djegë me qëllim ajo, se ka edhe të tilla zëra, por me rëndësi duhet me ardhur procesi, masandej na me ba planin. Na kemi pas procedura edhe rreth zyrës deri sa u kry ana formale, deri sa u kry procedura hetimore. Na nuk kemi mund me ndjek prapa tjerë. Çështja e rrugëve që u ngrit, edhe nga ana e Bekimit, edhe nga ana e Jakupit, janë shumë parimore, janë në interes të qytetarëve. Unë duhet me mendu bashkërisht me qeverinë, mi planifiku gjitha pjesët me prioritet, por edhe unë e di se edhe ju nuk bani pa prioritet kapërcime, po edhe kjo e ka fazën planifikuese dhe masandej fazën implementuese, mas fazës implementuese e ka fazën kritikuese. Ne I kemi zyrat përgjegjëse këtu, duhet mi shiku këto punë, unë për disa çështje që kanë ngritur këshilltaret nuk e kam zënë asgjë, i kam thanë me I qu në laborator analizat e disa rrugëve, normal që nuk janë pranuar ato punë, prandaj në këtë kuptim keni të drejtë. Edhe te rrugët bujqësore, ingjinerat janë këtu edhe këta kanë me dhanë përgjigje edhe të tjerët kanë me dhanë një nga një të gjithë për të gjitha, vetëm se duhet me bë prerje. Ajo që është bërë mirë është bërë mirë, ajo që nuk është bërë mirë, nuk ju paguhet, ajo që duhet me shkuar ma tutje shkon ma tutje. Është në procedurë, në këtë kuptim nuk ka me lëshua pe, kemi me qenë transparent llogaridhënës dhe kemi me qenë për secilin projekt insistues barabar që punët me u kry mirë. Janë ngritë shumë tema që drejtoret e drejtorisë janë këtu për me dhanë përgjigje, për shkak që ju takon se është domeni i tyre, u ngrit edhe një çështje se ndoshta kisha me mujt me ndihmua drejtoreshën e

kadastrit. Te pronat, çështja e pronave është çështje qeveritare. Ju e dini se është bërë një pezullim momental i shndërrimit të pronave, e dini se në gjykatë kushtetuese ka shkuar lënda, prandaj në këtë kuptim momentalisht është një momeratorium. Kërkesat tona janë që pronat e tona me u rikthye, u ngritën edhe tema të tjera për shëndetësi, na gjatë sezonës akademike normal që e rritim stafin, por mos harroni, me mungesën e stafit të KARITAS-it dhe rritja është e pamundur. Tana po kemi problem edhe me marrëveshje të përkohshme për me marrë. Janë ngritur edhe tema të tjera, që sigurisht do të ju përgjigjem, por unë kam menduar, se gjatë raportit, për shkak se e kemi informatën e punës për vitin 2018, mirëpo një falënderim për konstruktivitet për gjithë juve, ndoshta disave ju mbeta borxh. Ishte çështja e zjarrfikësve për Pozheran, normal që është mirë na me kriju njësi të re, e sidomos ne vendbanime të mëdha siç është Pozherani, që ka nevojë edhe me numër të banorëve. Na kemi me tentuar me shti në buxhet, nëse kemi mundësi na në Viti e kemi bërë objektin e zjarrfikësve. Ju e dini në çfarë gjendje kanë qenë, besoj që do të punojmë edhe në këtë drejtim. Unë erdha pak me vonesë, edhe Njaziu I ngriti disa çështje për shërbimet publike, nëse e shohim te mirëmbajtja, mundemi me thanë se ka qenë njëra ndër komunitat ma të mira që është mirëmbajtur. Drejtorin e mirëkuptoj, jo që po dua me mbrojt, po një drejtor që në ora 02:00 të mëngjesit e keni pas gjatë tanë javës, normal që e mbroj si kryetar. Me rendësi rrugët kanë qenë të kalueshme në tërë territorin e Komunës së Vitisë. Unë desha edhe diçka për fund, që para kuvendit, se si qeveri nesër do ta ftoj drejtorin e Bujqësisë ta falënderoj për aktivitetin edhe punën e mirë që ka bërë për 5 vite rresht. Ta falënderoj drejtorin e Bujqësisë, ka treguar rritje në efikasitet në punë në të gjitha parametrat, ka pas aktivitete, ka pas investime, ka qenë njëri prej bashkëpunëtorëve të shkëlqyeshëm, shumë profesional, i cili ka fol pak, por ka punuar shumë. Vërtetë meriton respekt, është fjala për Veton Ademin, i cili do të shkon në nivel tjetër në Prishtinë me punë. Na i dëshirojmë shëndet dhe suksese gjithë bashkërisht, dhe po ju informoj, se që nga nesër do ta kemi një drejtoresh të re të Drejtorisë së Bujqësisë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Edhe unë në emër të Kuvendit Komunal të Vitisë, ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur gjatë këtyre 5 viteve dhe i dëshirojmë punë të mbarë në misionin tjetër që ka, dhe po shpresoj që kryetari bëri përpjekje për tu përgjigjur në pjesën dërmuese të pyetjeve që i parashtrua dhe po shpresoj gjatë debatit që kemi tani, do të mund të përgjigjem edhe në pyetjet që janë parashtruar. Ndoshta me lejen tuaj, na kishim kaluar në pikat e rendit të ditës me pëlqimin e juaj. Faleminderit për mirëkuptim!

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

## **R e n d d i t e**

1. a) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së së Vitisë.**  
b) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme, e datës 27.12.2018 e KK-së Vitisë.**
2. **Informatë (Raport) për punën e Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2018.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit nr. 01-410/03-538, të datës 05.06.2018 për formimin e komiteteve konsultative.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjeve të takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bashkëpunimin ndërkomunal të qëndrueshme me Komunën e Kirchhain.**
6. **Draft Plani i punës për vitin 2019 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
7. **Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për vitin 2018.**

Kryesuesi, paraqiti edhe një pikë shtese të rendit të ditës, **Ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.** Kush është që të miratohet ky rend dite? Nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës me piken shtesë.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. a) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së së Vitisë**
- b) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme, e datës 27.12.2018 e KK-së Vitisë**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat rrethe procesverbalit, a ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

## **2. Informatë (Raport) për punën e Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2018**

**Kryetari z.Sokol Haliti:** I nderuar z.Kryesues i Kuvendit, Të nderuar Anëtarë të Kuvendit, Të nderuar Drejtorë, Përfaqësues të Institucioneve të Komunës, Media dhe Shoqëri Civile!

Kam nderin dhe kënaqësinë, që sot para Juve të paraqes Informatën për Punën njëvjeçare të vitit 2018. Në këtë informatë janë dhënë detajet e nevojshme të angazhimit tonë për periudhën paraprake njëvjeçare, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës sonë. Fjalën time hyrëse e kam përpiluar në formë të një përmbledhje ekzekutive të informatës (raportit), gjersa për detaje dhe punët specifike sipas drejtorive dhe zyrave, ju lus t'i referoheni raportit në plotësinë e tij pershkak se keni nje raport shume vuliminoz i cili eshte detal une e kame kerku kete sepse ka aktivitete shume.

Që nga marrja e mandatit të qeverisjes sonë, të mirëfilltë dhe efektive, kemi qenë shumë të angazhuar dhe përkushtuar në mirëqenien e qytetarëve tanë, e që realisht Vitinë e kemi kthyer tanimë në një komunë meritore për qytetarët e saj. Mirëpo, sukseset tona të deritanishme, nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, siç edhe mund të paramendohet, por besoj, se sukcesi ynë më i madh, i përbashkët, ka qenë bashkëpunimi i Kryetarit dhe i Kuvendit me Qytetarët, ku kërkesat e tyre i kemi shndërruar në projekte investive të ndryshme, që ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Viti 2018 ishte vit i sukseseve, ishte vit i realizimit të programeve të mëdha në shumë fusha, mbi të gjitha vit i partneriteteve të Komunës me organizata mjaft të fuqishme vendore e ndërkombëtare.

Me bashkëpunim të ndërsjellë, me mirëkuptim dhe punë të palodhur, ne kemi arrit, që në vitin 2018 të realizojmë me sukses një sërë projektsh, që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Vitisë.

Informata (raporti) që po e prezantojmë sot, përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë me prioritetet, si në vijim: Rritja e efikasitetit në Administratë; Zhvillimi i bujqësisë; Shëndetësia, Arsimi, Kultura dhe Sporti; Infrastruktura lokale; Shërbimet publike; Zhvillimi ekonomik; Përkujdesja për shtresat e varfra dhe grupet e marginalizuara; Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët; Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

**Administrata:** Drejtoria për Administratë, ka ofruar shërbime shumë kualitative për qytetarët. Janë lëshuar 51.984 dokumente. Numri i qytetarëve të cilët e kanë kryer verifikimin në gjendjen civile është 51292.

**Bujqësia:** Aplikimi i 2040 fermerëve për subvencione. Sektori i Bujqësisë, ka përcjellë procesin e korrje shirjeve në 5006 hektarë me grurë, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike, rendimenti ka qenë më i ultë, 3800 kg për ha. Me 1 Gusht, është mbajtur panairi regional "T'i ruajmë vlerat tona tradicionale", për nder të Ditës së Diasporës. Kanë përfituar shumë fermerë, si në: serra, farë patatesh, makina bujqësore, 13 kiosqe, fidaneve të bimëve mjekuese aromatike. Vlera totale e investimeve në bujqësi, nga komuna, ministria dhe donatorët, është 1,297,883.8 €.Janë pyllëzuar 20 ha me pyje.

**Arsimi:** Ngritja e kapaciteteve në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe krijimin e kushteve më të mira në shkollë. Përfundimi me sukses i procesit mësimor me rezultate të kënaqshme në testin e arritshmerisë dhe testin e maturës 75%.Renovimit të 14 objekteve shkollore me të hyra vetanake. Renovimin e çerdhes "Gëzimi Ynë", Viti ka qen nje prej sukseseve dhe nevojave me të mëdha që kemi pas që e kemi arrit ne 2018 dhe ju lus ta

vizitoni çerdhen. Vendosija e rrethojave në oborret shkollore. Rregullimi i parqeve dhe ambienteve në oborret e shkollave. Digjitalizimi i procesit mësimor, shpërndarja e lloptopëve, projektorëve, printer-copy. Inventarizim dhe rregullim i bibliotekave dhe kabinetet e informatikës. Ngritja profesionale e mësimeve përmes trajnimeve, konferencave dhe seminareve. Rritja e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Zhvillimi i shumë aktiviteteve jashtëshkollore dhe shënimi i datave të rëndësishme. Rekrutimi i personelit arsimor, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

**Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** Përgatitja e të gjitha projekteve kapitale; Inkasimi i tatimit në pronë 80%; Trajnimi i shumë bizneseve për menaxhim biznesi; Mbështetja e bizneseve për aplikim te donatorët; Mbështetja e investitorëve për investime në komunë. Kulturë, Rini dhe Sport: Vazhdimi i palestrës sportive në Drobesh; Vazhdimi i renovimit dhe ndërtimit të stadiumit KF "Vitia"; Renovimi dhe ndërtimi i stadiumit të KF "Vllaznia" në Pozheran; Ndërtimi i stadiumit ndihmës në Sadovinë të Jerlive; Ndërtimi i 8 fushave sportive në lokalitete; Shuma e subvencioneve për sport dhe rini për vitin 2018 është 52.175€.

**Urbanizëm dhe Mbrojtje e Ambientit:** Shqyrtimi i 16 kërkesave për leje ndërtimore; Shqyrtimi i 10 kërkesave për pëlqim urbanistik; Shqyrtimi i 9 kërkesave për kushte të ndërtimit; Viti 2018 është shpallur vit për pastrimin e ambientit; Shënimi i datave me rëndësi për pastrimin e ambientit; Vizita në teren; Aktivitete tjera kontinuele ku kemi fituar edhe grandin për performances.

**Shërbime Publike dhe Emergjencat:** Ndërtimi i objektit të ri të zjarrfikësve; Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror; Eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra; Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve; Pastrimi i hapësirave publike; Mirëmbajtja e ndriçimit publik; Dekorimi i qytetit; Inspektimi i objekteve publike dhe private nga inspektori i preventives ndaj zjarreve Intervencione nga shërbimi i zjarrfikësve.

**Shëndetësia:** Promovimi i shëndetit përmes ligjëratave për qytetarët për sëmundje të ndryshme; Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në mjekësinë primare dhe specialistike, ku numri i shërbimeve të ofruara për vitin 2018 është 421651; Janë mbajtur trajnime për stafin mjekësor dhe atë infermierik; Renovimi i disa hapësirave të QKMF-së në Viti; Renovimi i AMF-ve; Digjitalizimi i rëntgenit; Kompletimi i laboratorit me aparaturë medicinale; Vendosija e klimave në objektet shëndetësore; Rregullimi i ambientit të jashtëm në objektet shëndetësore, hapja e ambulantes se re ne Skifteraj.

**Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi:** Shqyrtimi brenda afatit ligjor i kërkesave të adresuara nga qytetarët, e që në numër janë 6000; Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale; Realizimi i të hyrave mbi 100%; Tërheqja e investimeve për çështje pronësore; Rindërtimi i informacioneve kadastrale në Pozheran, Sllatinë, Sadovinë e Jerlive dhe Zhiti.

**Inspeksioni:** Implementimi i të gjitha ligjeve në lëmin e inspektoratit; Inspektimi për ndalimin e ekonomisë jo formale për bizneset në Komunën e Vitisë; Inspektimi i kushteve sanitare dhe ushqimeve mbi cilësinë e tyre në të gjitha hipermarketet, marketet tregtare dhe bizneset tjera; Preventiva në kontrollin e sëmundjeve tek kafshët dhe asgjësimi i kafshëve të ngordhura në mënyrën më të mirë të mundshme; Vazhdimi i lirimit të hapësirave publike për projektet komunale; Vazhdimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për siguri në komunikacion; Kontrollimi i vazhdueshëm i ujit nëpër shkolla dhe për qytetarë.

Ju siguroj se institucionet komunale të Vitisë, do të marrin për zbatim të gjitha vendimet që merren në Kuvendin e Komunës si dhe do të jenë gjithmonë të përkushtuara për krijimin e një mirëqenie sa më mirë për qytetarët e Komunës sonë. Gjatë viti 2018 ne kemi kriju partneritet serioze me shume organizata qeveritare dhe jo qeveritare, me shumë mekanizma ndërkombëtar qëndron një pjesë e atyre propozimeve, do të vij sot, e keni një për Kirchhain. Seancën e ardhshme do ta kemi një me komunën kroate, ku kemi qenë me kryesuesin Velika Pisanicës, që kemi qenë së bashku me kryesuesin, që do ta kemi partneritetin që ka nënkruu ata dhe Komuna e Kirchhain, e ka miratu partneritetin, me neve është 2020-2030, një donacion nga Ministria e Zhvillimit të Gjermanisë, e kemi fitu, do të kemi edhe memorandume të tjera që do të dalin në Kuvend, do të shqyrton kuvendi, do të miraton kuvendi, bashkërisht do të implementojmë, jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës fillimisht fjalën jav jap shefave të grupeve parlamentare.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje Kryetar dhe ju të pranishëm! Sinqerisht e falënderoj kryetarin për këtë informatë të detajuar, që e paraqiti këtu para ne. Çka të thuhet me tepër krejt nga ajo që u tha. E kemi periudhën kohore janar-dhjetor, ne mënyrë të specifikuar u ceken të gjitha të arriturat për këtë periudhë kohore njëvjeçare si informatë e Zyrës së Kryetarit, duke u nisur edhe prej të gjithave zyrave që veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit, auditor i brendshëm, Njësia e Personelit, Zyra për Barazi Gjinore, Zyra e Prokurimit, Informimit, Zyra Ligjore etj, e kanë bërë një punë të mrekullueshme, një punë që është në harmoni dhe në përputhje me ligjin dhe të gjitha me profesionalizëm, që çdo zyre e ka në domenin e vete për mos me hi ne shifra, u ceken të gjitha nga kryetari, është bërë një punë e mirë dhe e madhe, ku edhe vlerësimin e kanë dhënë qytetaret, se me punën që është bërë në të gjitha drejtoritë, kemi rritjen e cilësisë dhe efikasitetin e të gjitha drejtorive që veprojnë në kuadër të komunës, projektet, mbikëqyrja, kryerja e punimeve, janë të gjitha në harmoni dhe besoj që vlerësimin me të mirë do ta japin qytetaret dhe të vlerësohet kjo punë që është bërë gjatë kësaj periudhe kohore.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E përsëris prap pyetjen për drejtoreshën e Arsimit, për mësimin jo formal. A janë gjet hapësirat financiare për mu pagu ata profesor për punën që e kanë bërë. Kryetar, pse nuk është përkrah qendra e strehimit të dhunës në familje “Liria” në Gjilan, ku në vitin 2018 jemi dëshmitar, sipas informacioneve të Plus TV, ku numri i rasteve të dhunës në familje është rrit në numër 41, sa ka qenë 21 në 2017, ndërsa në 2018 është 41. Më lejoni të ju përkujtoj, fatkeqësisht 13 viktimat gra janë në vitin 2018, prandaj nuk është një diçka që nuk ja vlen me investu, për arsye se ato viktimat të dhunës në familje janë edhe qytetaret të Komunës së Vitisë. Sa i përket Drejtorisë së arsimit, thuhet që ka fillu mësimi në fillim të vitit në shtator, mirëpo ka pas vështirësi, të gjithë jemi dëshmitarë, kanë qenë edhe dy koleg të mi aty dhe e kemi pas se çfarë forme janë prit. Shkolla nuk ka qenë e gatshme me 1 shtator shkolla “Bafti Haxhiu”. Kur jemi të përzgjedhja e drejtorëve, kryekëput është politikë një gjë të tillë, nuk mund ta mohoni, sa për ata që janë përzgjedh për hir të performances, se mirë, unë do ti quaj super të dëgjueshmit, që nganjëherë i tejkalojnë kompetencat e tyre edhe i bartin diskutimet politike, e përkundrazi sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar, ata do të duhet të ishin apolitik, fatkeqësisht përzgjedhja e mësimdhënësve për një vend pune behet në baza partiake, çka do që flas unë është e tepërt, gjithë e ka elaboru shume mirë edhe kolegu Ekrem Abazi, kur ka sqaru se si duhet sot të hysh në punë, duhet të jesh i afërt me pushtetin, duhesh të jesh reja e drejtorit, bija e drejtorit, fatkeqësisht ky standard është vendos. Nëse i shikojmë konkurset, ka raste për shkak të konfidencialiteti nuk do të them me emra, kjo është fakt që nuk merret parasysh përvoja, trajnimet. Personi që i ka 10 vite provoj pune nuk merret në punë, po merret personi tjetër, ku shume kjar në Ligjin 04L032, neni 35, paragrafi 1 dhe 5, shumë çartë e përcakton zgjidhjen e personelit arsimore, ku aty thuhet që arsimimi i secilit kandidat merret parasysh përvoja, kualifikimet për pozitën dhe nevojat që merret ai mësimdhënës. Këto nuk po merren parasysh, kam fakte, kam argumente, është paditur DKA-ja. Po ashtu për rimbursimin e fermerëve, për demet e shkaktuara gjatë vitit 2018, ekziston vendimi i qeverisë, po ashtu mu ka refuzu kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, e cila është publike dhe arsyetimi i cili është dhënë në bazë të ligjit dhe nenit në të cilin janë thirr, e kam verifiku edhe Ligjin e vjetër edhe Ligjin e ri, nuk ekziston, pse nuk me është leju qasja në atë dokument që ka të bëjë me kontratën KARITAS Kosova - Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna. Po ashtu ka raste kur konkurset publike që i shpall DKA-ja, konkursi anulohet, p.sh. për punëtor teknik të “Kuvendit të Lezhës”, arsyetimi është shumë i paarsyeshëm, thotë se mungesë të buxhetit. D.m.th, qysh hapet një konkurs kur nuk ka të siguruar buxhetin, jemi dëshmitar që këto dy vitet e fundit janë ekzekutu vendimet gjyqësore, që buxheti i komunës dëmtohet hiq me pak se në shumën 100 mijë euro, ku këto kanë të bëjnë pjesë edhe në fushën e arsimit. Disa janë edhe në proces e sipër, disa kanë përfitu konteste gjyqësore, ka padi nga ish mësimdhënësit të cilët nuk i kanë marr pagat e tyre jubilarë, që ju takojnë me ligj, me kontratën kolektive, ka edhe padi që janë të reja, ka edhe padi të me hershem. Drejtoresh, që tri vite e potencoj këtë problem, çka keni bërë ju si DKA, ku sipas raportit i cili me është jap nga Drejtoria e Inspeksionit, rezulton se nga 16 mostra, 30% prej tyre janë të kontaminuara, fëmijët tanë pinë ujë me baktere dhe të kontaminuar, ku ka edhe vlera të nitriteve dhe nitrateve. I njëjti raport me është kthyer edhe në 2016-të edhe në 2017-të, po sipas drejtorisë, flas gjithmonë sipas Drejtorisë së Inspeksionit, përafërsisht janë të njëjta vlerat. Këto janë të dhëna shqetësuese, sepse fëmija nuk e dinë se uji a është i kontaminuar apo jo. Kemi pas vendos me herët me fondacionin Kosovë Luxemburg, për do filtera, po gjendja në teren dhe në shkolla është kesi soji, fëmijët pinë ujë jo të mirë. Më shqetëson fakti, që persona me aftësi të kufizuara, përkrahja



institucionale ndaj tyre mungon. Pikërisht ne saje te kësaj, organizata joqeveritare e vetme e cila përkujdeset për këtë kategori të njerëzve edhe Hendikosi edhe Oskami, nuk kanë mbështetje institucionale, pikërisht për shkak të mungesës së buxhetit. Nje gjë të tillë LVV e ka paraqit edhe kur ka qenë buxheti, në muajin shtator, një nder 13 pikat që i kemi parapa, ka qenë edhe përkrahja për këtë grup të njerëzve te marginalizuar, sepse këta njerëz janë brenda në shtëpitë e tyre, nuk ofrohet asnjë aktivitet, po mos harroni edhe ata janë pjese e kësaj shoqërie dhe pjese e kësaj komune. Sa i përket digjitalizimit, procesit mësimorë, flas me kompetencë të plotë, që jo të gjitha aktivitet janë të furnizuar me kompjuterë dhe lloptopa, flas me kompetencë të plotë. D.m.th ka edhe ne gjimnaz, ka edhe në shkollën të mesme profesionale teknike, po edhe në shkollat tjera, prandaj kur të flasim për digjitalizim, duhet ta ketë tek secili edhe lloptopin, në mënyrë që të na heket shkumësi dhe tabela. Është një proces, i cili është në fillim e sipër. Po ashtu një çështje e cila është kontestuar nga drejtoresha e Arsimit është, se në Viti nxënësit i gjendet mariuana, nuk ka qen konstatim, është fakt drejtoresh, prandaj sa me shpejt që krijohet strategji dhe të merren masa në këtë drejtim, sepse të jemi dëshmitar sipas një raporti te Plus Info, se Anemonave përdorimi i mariuanes dhe bimëve narkotike është në rritje, prandaj jo gjithçka është ne rregulle. Prandaj duhet te merret parasysh kjo, sepse kemi të bëjmë me gjeneratat e reja, po ashtu flas gjithmonë sipas OJQ-së “Labirinthi”, që vitin e kaluar janë dikun rreth 5000 përdorues të ri të mariuanes. Ta keni parasysh këtë, sepse, kjo ka të bëjë me rininë, me të ardhmen e këtij vendi.

**z.Bekim Azizi:** Përsëritet të nderuar të pranishëm! Gjatë këtij viti ka pas punë, ka pas të mira, ka pas të këqija, mirëpo unë do të kyçem ne atë që e shohim si pjesë e opozitës, prej faqes 23, ku thotë: “rregullimi i stacionit të autobuzave” d.m.th 19 mijë euro stacioni i autobusëve, edhe me herët 40 mijë euro, d.m.th ka qenë një rregullim edhe në fund investon komuna dy vjet ne stacion të autobuzave, edhe kryetari e takon drejtorin e stacionit te autobuzave ne Gjilan dhe do me jav dhënë në shfrytëzim. Çfarë interesi është ketu, këtë e ka kryetari në dy seanca, ne KPF ja kemi kthy mbrapa, që nuk e kemi leju, sepse e kemi pa qe kjo është punë jashtë çdo norme, çdo rregulle. Projektet e investimeve nga niveli qendrorë, bashkëfinancim me komunën, renovimi i shtëpisë se kulturës 248 mijë 605, prapë renovimi i shtëpisë së kulturës me BE-në 182 mijë, d.m.th të dyat kanë investu. Këtu duna një informatë, ndërtimi i shkollës ne Pozharan, projekt trevjeçar, kaloi trevjeçarja hala në temel është, kërkun nuk është. Zgjerimi i rrugës Drobesh-Mugillë, projekti dyvjeçar 2018-2019. Unë vi për ditë prej Smirës në Drobesh, u zgjenu rruga fort, a thotë projekt i kryer. Krejt kaloni aty parni, e dini a u bë apo su bë. Zgjerim i asfaltit Sharovinë e Jerlve ne Dardani, a e dini kur u kanë problemi i kyqjes ne autostradë edhe një memorandum bashkëpunimi e bënë kryetari me ministrin Zharku në atë kohë dhe i ndajnë 600 mijë euro për me e fillu një rrugë prej Sadovinës dhe mu lidhë në Sojevë, për shkak që nuk është bë kyqja dhe ata e marrin tash ja japin nja tre centimetra asfalt ne Sadovinë dhe thojnë zgjerim. Nëse ka zgjerim qatu, shkoni kush doni matne a ka zgjerim apo nuk ka, ndërsa ne Sllatinë e kanë blloku, aty paqare duhet me zgjeru se e kanë blloku. Te Zyra e Regjistrimi të Bizneseve, 179 biznese janë hapë, mirë çdo biznes që hapet. Unë mendoj që është puna me e mirë që duhet me bë dhe duhet mi dhënë mundësi që te ketë sa më shumë biznese, 34 të mbyllura, mirë është, ka interesim për hapje të bizneseve, mirëpo u kanë mirë qeto 134 me përmend bre një far fabrike të tekstilit, se na keni pas bë horë, kryetari ne fushata merr njerëz, qo, qit në faqe të komunës që po i pranoni 500 punëtorë me tri ndërrime, po punoni, kanë punu njerëzit nja 5-6 muaj, nja 200-300 vetave nuk u kanë dhënë rroga hiq nja dy tre muaj. Unë e di që komuna nuk e ka qel ata, mirëpo e keni bë, e keni përdor për fushatë, po të kallëzoj, shumë. Punëtorët kanë met pa rroga aty qe i keni qu ju aty për vota. Te shërbimet publike, thotë janë zgjeru disa fshatra me mbledhjen e menaxhimit të mbeturinave. Unë e di që kanë hi në menaxhim të mbeturinave disa fshatra më shumë, po qeto fshatra që janë tu hi drejtor, unë mendoj që fshati duhet të përfshihet komplet. Janë vetëm disa rrugë kryesore ku “Eko Higjena” ka mundësi me shku me kamjan, ndërsa nuk është i përfshirë fshati komplet. Në këtë aspekt duhet me pas kujdes, që fshati komplet me hi ne menaxhim te mbeturinave. Te QKMF-ja ka mjek të mirë që duhet me i falënderu, mirëpo unë e di që po thotë këtu digjitalizimi i rengenit, na e dimë që nuk ka mjek të ultrazërit, as mjek të rengenit nuk ka, nuk janë funksional, ka hec doktor Nazimi, nuk ka mjek ma aty. Thotë funksionon gjinekologjia. Unë e di që mjek gjinekolog nuk ka, na krejt e dimi këtë, për objekt, për zyre mos me tregoni mu, gjinekologjia funksionin kur ka mjek gjinekolog, ti qohe sa dush njerin aty te tavolina, nëse nuk ka mjek, ne raport po shkrun që ambulatat nuk kanë mjek, përpos Begunce tri herë ne javë ne Begunce aty ka pas mundësi, ndoshta kryetari me qu, te Drejtoria e Arsimit përpos 100% të konkurseve të derigjume pranimi 100% me të njohshëm që janë pjesë e juaja. Ju kisha thanë keni pas gjatë vitit 2018 Kryetar një marrëveshje me një far mashtruesi të GIZ-it, ka luft me nxënës, ju ka marr pare i ka qu ne Brezovicë. Ti kryetar ki pas marrëveshje

edhe e di kur e ki thirr në tel drejtorin e shkollës, kam qenë aty, keni bisedu. Shqyrtimi i ankesave nga ata që nuk i pranoni në shkollë, edhe bëhet një komision ne shqyrtim të ankesave prej njerëzve që i keni pranuar nja 1 vit apo dy me herët, besoni pa konkurs i keni pranuar, e qata i shqyrtojnë ankesat kush ankohet, dikush që nuk e keni marr në punë. Kjo është gjynah, edhe kur ta bëni mos i shtini bre mësimdhënësit, se na jemi koleg në mese veti, ka njerëz tjerë aty pari, shtine najkan tjetër. Te vlerësimi, te pranimi i mësimdhënësve, çka e morra një raport, çka e kanë bërë me një konkurs, ku kanë konkurru 15 veta dhe p.sh. përgatitja shkollë, fakulteti i ka 8 pikë, testi me shkrim i ka 100, testi me gojë 100 pikë, test me gojë nuk ka, ka intervistë me gojë, gabim është test me gojë. përvoja e punës e ka 1 pikë, desh punove 20 vite desh 1 ditë e ki një pikë, nuk guxon kjo me ndodhë. Po e marr që është lëshim, nuk guxon kjo me ndodhë me marr pikë të njëjta, si një që punon që 20 vjet, si një që 1 ditë, është gjynah, përmirësoni këto gjera. Te Drejtoria e Bujqësisë, gjatë tërë vitit, 65 metra dru janë konfisku, për një vit 65 metra dru. Na jemi tu e pa se çka është ka ndodhë krejt. Ky vend 50 mijë banorë nxehen me dru, 65 metra dru të konfiskuara, po me doket që nuk është me rregull, dhe shitja e druve, ne e dimi çka ka ndodhë me shitjen e druve, qysh keni mujt.

**z.Rasim Terziqi:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Bekimi e përmendi shkollën e Pozharanit, unë nuk po flas me inati, po e kam në aspektin pozitiv, shkolla e Pozharanit nuk është bash qat nivelin e themelit, ka hecë mirë, këtë vit nëse vazhdon me këtë hecje, në 2019 kemi me shku ne shkollë të Pozharanit. Po çka nuk jam i kënaqët të stadiumi “Ibrahim Kurteshi”. Kryetar, kemi ngec shumë, d.m.th në Sadovinë u krye shumë mirë stadiumi, në mënyrë profesionale me të mirën. Gjithashtu edhe në Viti u krye stadiumi, ndërsa në Pozharan kemi ngec. Problemi mujt me thanë, që operuesi sa tu e krye punën, mirëpo ai e hedh fajin të komuna. A ka mundësi një sqarim kryetar, për qytetaret e Pozharanit. Një fushë e futbollit të “Lagjja e Muhaxherve” është e premtume kryetar, i ki ndreq fusha të futbollit ne krejt komunën, edhe ne fshatra më të vogël se “Lagjja e Muhaxherve”, e sot ajo lagje pa fushe futbollit ata femij ka met ma lujt futboll e ki premtim elektoral kjo eshte tash kerkese e banorëve të asaj lagje. Te qeky binjakëzimi i partneritetit me Kirshhanin, unë nuk e di, vetëm kam qef me ja shpjegu qytetarëve, se çka sjellë rezultate ky binjakëzim, partneritet, rezultate, ne mujt mu taku, ka kosto edhe takimet, p.sh. ne me shku ne Gjermani e me u akomodi ne hotele, e delegacionet e huaja me ardh prej Gjermanisë mu akomodu këtu, ajo kushton kosto, nëse ato nuk kthehen në investime, atëherë çka bëjmë binjakëzime partneriteti.

**z.Taulont Haxhiu:** Kryetar, unë fola për kontratat mbi vepër, nuk më ktheve përgjigje hiq, as nuk më thave që do të mi sjellin organet kompetente. Mos të merremi çdo seancë me këtë temë. Unë kërkoj prej teje me ditë qet urën prej 300 mije euro, a u kanë bashkëfinancim apo u kanë në kuadër të komunës, ura te shkollat e mesme, kjo urë 300 mijë euro, 300 mijë euro nuk e di a është ura e San Franceskos apo ura e Vitisë. Unë du informata për këtë urë. E di që përfitues i kësaj ure është vllau prej njëres prej drejtoreshave këtu të kuvendit komunal, është përfituesi i të gjithë tenderëve që jepen në Komunën e Vitisë. Dije një kryetar, në çoftse nuk me i jep informatat, unë personalisht ka me i marr ekspert, ka me i pagu vet prej gjepit tem, edhe du me i dal deri në fund kësaj ure. 300 mijë euro një urë, këtu me siguri është fry kjo shifër edhe dikush këtu naj simpatizant apo naj militant, ka marr ndonjë shifër të caktuar, sepse 300 mije euro një urë, kjo po me doket absurde. Unë për këtë urë zotëri Aliu dhe zotëri Haliti, du ne seancën tjetër me e dite komplet informatat rreth urës, i shkojmë deri ne fund. Nëse nuk vjen informata, besoj që ka me ngrit këtë deri ne prokurori. Për shëndetësi foli me herët Sejda, është e vërtet që një ditë unë e kam pas një udhëtim jashtë shteti, edhe pata një ngritje të shtypjes enorme, dikun 160 me 120, tash kur shkova ne ambulant, aty ishin kanë tu prit 14-15 vete, po ish kanë një mjek, unë mos kesh me thirr Qamil Ajetin, që është kryeinfermier, me ma dhënë një injeksion, unë kesh tu maru kryetar. Mos luj me ndjenja të qytetarëve, te shtëpia e shëndetit ne Viti, të ketë më shumë mjek në ndërrimet e caktuara, sepse po rrezikohen qytetarët.

**z.Nijazi Isaku:** I nderuari kryesues, kryetar, menaxhment, të nderuar të pranishëm. Raporti njëvjeçar i Kryetarit të Komunës për periudhën Janar - Dhjetor 2018, nëse shikon si material i prezantuar, në përgjithësi e vëren se pjesa dërmuese është përshkrim i punëve të zyrave të kryetarit dhe drejtorive të komunës. Se sa është profesional i përgatitur ky raport e kupton vetëm kur fillon ta lexosh, ku janë prezantuar një mori informatash të pa nevojshme, vetëm për të krijuar një përshtypje se është punuar shumë. Te përmbledhja ekzekutive e fjalës se kryetarit, i cili ceku, se: “Vitinë e kemi kthyer tanimë ne një komune për qytetaret e saj”. Kjo aspak s’është e vërtet, qytetarët e komunës tonë meritojnë shume e me shume se çka ka ofruar kjo qeverisje. Qytetarët e komunës tonë meritojnë një qeverisje me transparente ndaj shpenzimeve te parasë publike, meritojnë punime më cilësore

dhe me standarde te kryerjeve te punëve ne infrastrukturë, qytetaret meritojnë dhe kane te drejtë të jenë të barabarte ne procesin e punësimit, e siç dihet më publikisht për të fituar një vend pune si kriter kryesor është librezja partiake. Po ndalem te Njësia për Auditim të Brendshëm, ku brenda këtij viti ceket se ka audituar 3 auditime me rrezikshmëri te larte. Nga to njëri me rrezikshmëri të lartë - Të hyrat nga tatimi mbi pronën e paluajtshëm për periudhën kohore 2017. Ku janë dhëne 5 rekomandime, të cilat ne nuk i dije cilat janë. Po ashtu, si raport i audituar ceket edhe Procedurat e Prokurimit Publik, a ka te gjetura dhe rekomandime në këtë raport nga Auditori i Brendshëm. Dhe pyetja ime është a po zbatohen këto rekomandime të Auditorit të Brendshëm, për arsye se është e gjetur në Raportin e Auditimit të Jashtëm te vitit 2017 mos zbatimi i rekomandimeve të auditorit të brendshëm. Aty thuhet se nga gjithsej 25 rekomandimet, vetëm pesë (5) ishin zbatuar plotësisht, nëntë (9) ishin në proces të zbatimit ndërsa 11 të pazbatuara. Mos zbatimi i rekomandimeve nga menagjmenti dhe kryetari, të jep të kuptosh mosgatishmërinë për kontrole të brendshme.

Zyra e Prokurimit – sipas këtij raporti ne këtë zyre janë zhvilluar 67 prokurim apo me thjesht janë nënshkruar 67 kontrata me operatore ekonomik. Dhe pikërisht kjo zyre edhe ne vitin 2018 ka qene e pa qasem sa i parkete informatave për publikun lidhur me aktivitet e kësaj zyre. Kjo mungesë totale e transparencës të kësaj zyre dhe mosgatishmëria e kryetarit të komunës për transparencë në këtë zyre, mendoj qe ka qene mjaft shqetësuese për neve. Nëse shikon Web faqen e Komunës së Vitisë, vetëm nga muaji tetor kanë filluar t'i publikojnë kontratat e nënshkruar ne ueb faqen e Komunës, ku kemi vetëm 13 kontrata te publikuar nga 67 kontrata ne nënshkruara ne vitin 2018. Ne si Vetëvendosje, e kemi ngritur si shqetësim edhe në mbledhjet e kaluar të kuvendit komunal. Po ashtu, këtë mos transparencë e kemi edhe si të gjetur e Auditorit të Jashtëm mungesa e njoftimeve për tenderët e suksesshëm për tenderët e pasuksesshëm dhe të eliminuar, qe e benë edhe me te dyshimte mungesën e kësaj transparence. Kur kjo kërkohet edhe me Ligjin për Prokurim Publik. Mungesa e njoftimeve për tenderuesit e pasuksesshëm dhe të eliminuar, pamundëson të drejtën e tyre ndaj paraqitjes së ankesës në rast të mos pajtimit me vlerësimin e Autoritetit Kontraktues në këtë rast ndaj Zyrës së Prokurimit të komunës.

Avokati Publik i Komunës - në këtë informatë, përveçse është prezantuar numri i lëndëve gjyqësore për vitin 2018 dhe përshkrimi i tyre, askund nuk gjen cili është suksesi i kësaj zyre, cilat janë të arriturat, sa lëndë janë fituar në dobi të komunës, sa lëndë rrezikojnë t'i humbin dhe kostoja financiare e humbjes së këtyre lëndëve. Po ashtu, është cekur edhe 6 lëndë kontestimore që këtë e kemi ngrit edhe me një mbledhje të me hershme në gjashtëmuorin e parë, ku me padi punëtorët e pensionuar të arsimit, e të cilët kanë kërkuar 3 paga jubilarë dhe 3 paga përcjellëse. Pse është e nevojshme të ngritet padi ndaj komunës nga punëtorët e saj, kur dihet fare e mire se këto paga të njëjtëve u takojnë me kontratën kolektive. Në këtë rast, buxhetit komunal për shkak të këtyre padive i shkaktohen shpenzime të procedurës gjyqësore të pa nevojshme.

Drejtoria e Financave, sektori i tatimit ne prone ceket se realizimi i planit për tatimin ne pronë shprehur ne përqindje është realizuar 82.38% (faqe 24), por, kur shikon pasqyrat financiare te vitit 2018, aty prezantohet tjetër përqindje. Te hyrat vetanake, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 75,64 %. Drejtori i Financave s'paku te jep një përgjigje lidhur me këtë përqindje.

**z.Besim Ymeri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket punës së qeverisë komunale, unë si qytetar I Vitisë dhe njëkohësisht si deputet I këtij kuvendi, për një vit të tërë kam arrit të shoh dhe përmbledhë të dhëna që thuj I kam nda ne disa kapituj, ku në shumicën e tyre nuk kam mujtur të gjej ndonjë të met që vlen të theksohet, edhe pse ndoshta kishte mujt të behet edhe ndryshe, por në përgjithësi mund të theksoj, se është punuar mjaft mirë, kemi mjaft punë për të bërë në shumë sektor, që janë bartur prej vitit që shkoj, ku disa punë madhore kanë filluar dhe vazhdojnë ende gjate leximit të raportit të punëve tuaj njëvjeçare, jam ndalur ne secilën prej pikave që kam analizuar, çdo detaj të punës suaj, mirëpo kam një vërejtje për ju, që ky raport ka qenë shumë voluminoz dhe më është dashur shumë kohë për ta lexuar dhe analizuar, gjë që kam ardhur në përfundim, se është punuar mjaft ne të gjithë sektorët, veçanërisht dashta të veçoj, që sektori I shërbimeve publike, shëndetësi, bujqësi dhe arsim, nga të arriturat e tjera, theksoj se Vitia u zgjodh fituese e grandeve të përzgjedhura në 5 komunat me të pasura të Kosovës dhe I përshëndet qytetaret e Vitisë, qeverinë komunale, kryetarin dhe të gjithë të tjerët për punën e jashtëzakonshme që është bë në komunën tonë. Unë si përfaqësues I këtij kuvendi jam I kënaqur me punën dhe rezultatet e arritura ne komunën tonë, sepse çdo gur që vendoset në ndërtimin e një jetë me te mirë për qytetarët e Vitisë, do të thotë se na ja kemi arrit qëllimit tonë, prandaj duke ju falënderuar për pune të mbarë dhe suksese të reja, ju falënderoj për vëmendje e juaj.

**znj.Xhilsime Qamili:** Përshëndes punën e kryetarit Haliti me bashkëpunëtorët e tij në përpilimin e këtij raporti njëvjeçar. Ky raport që ne e kemi para vete, tregon një përkushtim qasje të drejtë transparencës të kryetarit në kryerjen e obligimeve dhe detyrave ndaj qytetarëve të Komunës sonë. Në raport shifet se janë të paraqitura të gjitha të dhënat e të gjitha drejtorive veç e veç, si dhe sektorëve në veçanti për punën të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore, janar-dhjetor të vitit 2018, me qëllimin e arritjes së objektivave për qytetarët e komunës sonë, për tu ofruar shërbime sa më të mira dhe më cilësore karshi tyre. Ajo çka vlen për tu theksuar, por edhe të vlerësuar lart, është, se vitit 2018 ishte viti i sukseseve, i realizimit të programeve të mëdha në shumë fusha, mbi të gjitha vit I partneritetit të komunës me organizatat mjaft të fuqishme vendore e ndërkombëtare. Sa I përket listës së projekteve kapitale, e kemi një punë voluminoze në teren, janë projekte të cilat shifen dhe po preken çdo ditë nga qytetarët tanë. Krejt në fund mund të them, se kryetari dhe ekzekutivi, për çdo vit kanë arritur ti përmbushin detyrat edhe obligimet, duke e respektuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe planin e punës të paraparë që ne fillim të vitit. Do t'i përgjigjem edhe Sejdes. Unë e di, I përgëzoj punën e stafit të emergjencës, mirëpo se di Sejda a është I njoftuar, se në Viti, e vetmja komunë është që ekzistoj dy qendra, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendra e Mjekësisë Familjare, që funksionojnë 24 orë, plus kësaj e kemi edhe mjekun permanent, I cili 24 ore është i gatshëm për rastet të renda në komunikacion, raste të ndeshjeve apo raste të tjera si dhe raste shtëpiake, të cilat kërkojnë ndihmë pas orës 15, të ju ofron mjeku permanent që ekziston. E di që pritjet janë të gjata, e di që ka vështirësi, por tash për momentin e kemi një gjendje të tillë, që askund në Kosovë nuk besoj që e kanë një organizim të tillë. Është për të përgëzuar menaxhemntin që prej fillimit të mandatit ka bërë këtë menaxhim.

**z.Basri Sylejmani:** Përshëndetje për të gjithë! Unë kam pak për raportin e kryetarit, pika të shkurta. Prej Sadovine nuk ka rrugë pa asfaltim, që 20 vite që janë të gjitha partitë në Sadovinë, nuk ka pas asnjë rrugë të shtrume deri sot, dritat janë vnu edhe qendrës kryesore edhe në fshat, fusha e sportit është e mrekullueshme, punimet janë në rregull. Për Goshicë po tregoj, për ambulant nëse ka kthyer raport policia, a është djeg me qellim apo është djeg nga rryma, atëherë na nuk kemi se çka bëjna as këta.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kur flasim për raportin njëvjeçar, duhna të them se është një raport mjaft voluminoz, i cili ka dashtë shumë përqendrim dhe me të cilin kam ardh në konstatime të shumta. Po u cekem shume nga parafolësit, mirëpo tek Drejtoria e Inspeksionit, ndoshta nuk reflekton mirë për pozitën që po dal, mbas atyre fjalëve miradije që u thanë, mirëpo unë ju bashkëngjitem opozitës dhe do ti jap vërejtjet që unë mendoj nuk kanë qenë në rregull të ky raport. Tek Drejtoria e Inspeksionit, më saktësisht të inspeksioni, mbrojtja dhe mjedisi, nder të tjera thuhet shume gjera, po me sa unë e kame kuptua aty, vetëm konstatohen dhe nuk thuhet gati se asgjë, përpos konstatimeve në jemi të interesuar të dimë se çfarë është ndërmarr, se për konstatime edhe në si grup parlamentar kemi konstatuar, kemi ngritur çështje, vërejtje lidhur me këto. Në raport thuhet, se me kërkesën zyrtare kemi intervenuar në dy raste, në Komunën e Kllokotit dhe kemi zgjedhur kontestin. Si është e mundur që në komunën tjetër të zgjidhen kontestet, ndërsa në komunën tonë ato vetëm të konstatohen. Thuhet që janë bërë pyllëzime të shumta në qytet, në rrugën "Muharrem Muharremi", drejtimi Viti-Drobesh, kemi evidentuar 5 prerje të fidanëve, drunjtëve dekorativ dhe rasti është kaluar në polici, por nuk jepet shpjegim fare pse janë prer drunjët para qendrës për shërbime sociale. Me sa e di unë, aty kanë qenë disa drunj bukur të mirë, nuk po flas për çka shërbejnë ata, se e dini edhe ju të gjithë, po mendoj që ka pas zgjidhje që mos të prehen ata drunj, mandje nga Komuna e Ferizajit nuk janë marr masat për vjedhjen e ujërave të zeza nga kanalizimi kolektiv në fshatin Sllatinë e Epërme dhe Sadovinë e Qerkezëve. Siç e dini ju, për këtë problematik, në si VV kemi fol në seancat e kaluara me 27, 26, 30, dhe prap me 27.09 2018 dhe as në këtë raport nuk është dhënë kurrfar çështje se çka është zgjedhur, pra nuk është dhënë kurrfar përgjigje, prandaj në si grup i VV-së, kërkojmë që këto çështje të konstatuara të jenë si çështje të zgjidhura në afatin e ardhshëm apo në vitet e ardhshme e jo të shkojmë vetëm në konstatime. Dhe krejt në fund, që mos të marr kohën, nuk di kanë ta akuzoj, drejtorin e drejtorisë që ka konstatu dhe evidentuar problemet, të cilët janë apo dikan tjetër I cili nuk I ka mundësuar, që këto konstatime të bëhen realitet, ti sanoj.

**z.Samet Idrizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e falënderoj kryetarin për ofrimin e informatës për punën e kryer gjatë vitit 2018. Unë do të fokusohem te Zyra e Auditimit, Zyra e Prokurimit, megjithëse këto dy zyre nuk janë zyre të mandatuara sikur e drejtorisë, mirëpo janë zyre me rendësi për mirëvajtjen e punës në komunë. Po ashtu do të fokusohem edhe të Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria për Shërbime Publike. Sa I përket Zyrës së Auditimit, që shkruan në raportin e kryetarit, thuhet se Zyra e Auditorit ka planifikuar me I bë 7

auditime, që për mu është pak kjo, tu e dit volumin e punës në komunë dhe ashtu ky plan nuk është realizua, ku I kemi vetëm 5 auditime. Kërkoj një sqarim, pse nuk janë realizu të 7 auditimet edhe sa I përket rekomandimeve që I jep 22 rekomandime komplet ne te gjitha dikasteret për vitin 2018, më duken pak janë, sepse me siguri duhet me pas lëshime dhe parregullsi me shumë kisha kerku personalisht prej kryetarit të jetë me I qasshëm në këtë zyre. Kjo zyre e ka rendësinë shumë të madhe. Te Zyra e Prokurimit e pash që kjo zyre ka procedu dikun 3 milion e 500 mijë shuma të kontratave që është një vlerë shumë e madhe edhe prej efikasitetit transparencës apo profesionalizmit që udhëheq kjo zyre edhe projektet realizohen ne teren, kuptohet në mënyrë me profesionale me mirë tu e respektu planin dinamik, kuptohet shumën e parave, plotësimi e kriterëve, cilësinë e punës etj etj. Na e dimë, se viteve të fund ka bë disa lëshime Zyra e Prokurimit, kemi p.sh.: ku auditori për vitin 2017 apo 2016 nëse nuk gaboj, gjenë aty mungesë të dokumenteve bazë, d.m.th deklarata e nevojave dhe disponushmeria e mjeteve nuk ekziston, që është dokument bazë inicues I një projekti për një lëndë të prokurimit, andaj kërkoj nga kryetari që vetë kryetari të bëjë një kontroll më të madhe, sidomos ne Zyrën e Prokurimit dhe te Auditimit, në mënyrë që mos të na përsëriten këto, megjithëse tash kemi një prokurim elektronik, ku është letesu puna shumë. Sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit, unë kam vërejt, se gjatë vitit kemi shumë raste ku qytetarët e papërgjegjshëm shkatërrojnë investimet kapitale që bëhen, kam pa disa raste edhe kubzat sa të forta janë, I shkatërrojnë, thyejnë drita. Është mirë, që Drejtoria e Inspeksionit të ketë një bashkëpunim me Policinë e Kosovës, në mënyrë që ata njerëz të kapen dhe të dënohen, të përgjigjen para drejtësisë. Unë kam udhëzua që të vendosen kamera mundësisht ne disa rrugë të Vitisë, sidomos aty ku qytetarët po e dëmtojnë pronën publike. Sa I përket Drejtorisë për Shërbime Publike, kisha kerku edhe prej drejtorit të Financave, kryetarit dhe drejtorit të Shërbimeve Publike, ta kenë një koordinim me të mirë, që për vitin 2019 dhe viteve tutje të ndaj buxhet me shumë në këtë drejtori. Na e dimë që janë shyt parqet, janë shyt rrugët që ndriçohen, e kemi rastin ku përshebull disa fatura të Shërbimeve Publike shume me rendësi nuk mujn mu pagu prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, sepse nuk janë nda mjete me kohë, d.m.th nuk ka një koordinim të mirë mes Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe kryetarit. Edhe njëherë kërkoj, sidomos faturat çka kanë të bëjnë për shërbimet e ujësjellësit “Eko Hixhenes”, ato duhet me kohe mu nda mjete, e ne fund të viti mu pagu tërësisht.

**znj.Liridona Bislimi:** Përsheendetje të nderuar të pranishëm! Sa I përket raporti të punes së kryetarit, u përmenden shumë çështje, do mundohem ti ceku disa tek faqja 10, në fund thuhet se me 29.06.2018, Ministria për Komunitete dhe Kthim, ka kërkuar informata për vështirësitë që përballen personat e zhvendosur, me theks kur ata kanë nevojë për të marr dokumente personale, ndërsa krejt ne fund thuhet, se ky grup punon ne kuadër të zbatimi të planit të veprimit në kuadër të procesit Shkupit. Kërkoj sqarim, çka do të thotë procesi I Shkupit, pasi që nuk e kam të qartë. Në faqen 14 thuhet, se seancat e kuvendit janë ingjizuar dhe transmetuar ne media lokale, në bazë të kontraktimi me to dhe Zyra për Informim e ka monitoruar gjatë transmetimit. Kujtojmë se gjatë vitit të kaluar, 6 muaj nuk kemi paguar transmetimin dhe seancat ne Kuvendin Komunal të Vitisë nuk janë transmetuar 6 muaj tek qytetarët. Në faqen 34 të raporti thuhet, se është bë pranimi I një dolladi blub i katërt automaneve. Termin automan nuk e kemi të kjart, nëse ka mundësi një sqarim. Tek Shëndetësia, më intereson ta di, edhe pse përafërsisht kryen 700 lindje brenda vitit, a është funksional reparti specialistik I gjinekologjisë, apo funksionon vetëm me motrat meridionale. Ndërsa tek faqja 37, tek shërbimet speciale, ne fund thuhet, gjatë këtij gjashtëmujori, puna në QKMF, duke e krahasuar me të kaluarën, mund të vërejmë ndryshimet e theksuara, si ne aspektin e orarit te punës, si ne cilësinë e shërbimeve të ofruara mjekësore, pra nga kjo na bënë të kuptojmë, që deri me tani të gjitha ato lëndimet në cilësinë e shëndetësisë nuk paskan qenë edhe të vërteta. Tek Arsimi, me intereson ta di, pse po vonohet procesi I publikimit të bursave. Po fillon semestri I dytë dhe ende nuk ka asgjë të publikuara, ndërsa ne faqen 50 të informatës, tek Sektori I inancave dhe investimet kapitale, tek furnizimi me dru zjarri për vitin shkollorë 2018-2019, thuhet se janë ble 2865 metra dru, me çmim prej 42.90 euro. A nuk po ju doket çmimi i lartë për një metër, 42.90 cent?

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Kryetar, u parashtruan një numër I madhe I pyetjeve, fjala është për ty.

**Kryetari I Komunës z,Sokol Haliti:** Faleminderit për pyetjet për interesimin për këtë debat. Kjo tregon se vërtetë informata ka zgjuar interesim. Kjo tregon se jeni aktiv si kuvend dhe me vjen mire vërtetë, pavarësisht se unë si kryetar komune e kam kaluar tërësisht petkun partiak, shpresoj edhe vazhdimisht pres që me kalua edhe këshilltaret komunal petkun partiak. Unë po filloj një nga një me u përgjigj në pyetjet që parashtruat. Ne si Viti kemi shumëçka për me ec përpara, mundësisht ju kërkoj falje nëse ndonjërit skam mund me ju përgjigj ose nuk

ndërhy në domenin e drejtorëve. Së pari te Mirlinda. Faleminderit për pyetjet, qendra e strehimit të dhunës në familje, shiko unë nënkryetarin e detyrova me shkua jo për me të demantu, se edhe ti e dinë që nuk është ashtu, por po duhet me than diçka në Kuvend. Unë plotë vendime kanë që e argumentoj se nuk është ashtu si po thua ti. Ne kemi vendime që e kemi ndihmuar Hendikonin, Oftakosin edhe shumë shoqata të tjera, bile kam vendimin që e kemi ndihmuar edhe qendrën e strehimit të dhunës në familje në Gjilan, por mos harro, na kemi edhe rregullore, ata konkurrojnë simbas rregullave në fuqi. Nëse I plotësojnë kushtet, rregullorja ja u miraton. Kur shpallet konkursi për subvencione , për qasjen në dokumentet zyrtare. Ja Vitia ju jep mundësi qasje në dokumentet zyrtare ja nuk e di që ka një komunë, përveç atyre që lejohen, ato që nuk lejohen normal që nuk ju a japin. Zgjedhja e drejtorëve politik. Shikoni, besoj që pajtohemi se kemi drejtor ma të mire në nivel vendi të shkollave momentalisht. E di që I dini, nuk kam nevojë me I përmend. A janë politikë, unë po them se nuk janë politik, janë shumë profesional. Ekzekutimi I kontesteve gjyqësorë, po vazhdojnë me I ekzekutua, po vazhdojnë me na I marrë paret nga thesari, është e vërtetë që po, I keni informatat, por nuk po I keni të plota. Është mirë me I marr të plota, p.sh.: na I kanë marr tash vonë 78 mijë euro për kanalizimin e Terpezës. Unë nuk jam tu fol me tendenca, unë jam ka flas me fakte, kanalizimi I Terpezës ka qenë e qeverisë Arifi, edhe nuk na ka vet përmbaruesi. Te kontestet që përmendi, po dua me të informuar sinqerisht, sekt na I ka marrë 12 mijë euro punëtori I shkollës suaj ku punon Mirlinda ti edhe Bekimi, rojtari I cili gjatë eksplozimit të shoqatës së gjahtarëve, ka pësua lëndime dhe gjyqi ja ka një dëmshpërblim prej 12 mijë eurove dhe paret na I ka marr prej një kodi që na ka lanë shumë keq. Ti the Oksfam, jo nuk ka asi, kemi Hendikon edhe Oftakos. Bekim Azizi për stacionin e autobusëve. Natyrisht, për shkak të transparencës edhe projektet që I paraqet pagesat që bëhen vitin tjetër duhet me I paraqitë edhe projekti përfundon, moment që përfundon edhe financiarisht. Te stacioni I autobusëve, reagoja nga vendi sepse ajo është tendencioze, por është mirë që po e qelet stacionin e autobusëve, nuk e kam bërë për vete, as nuk e kam bërë për interesa partiake, gjendjen që ka qenë stacioni I autobusëve e dinë të gjithë. Na me pak pare e kemi pru në këtë gjendje që është tash. Çka nevojitet, faza tjetër është me funksionalizuar, cilat janë format e funksionalizimit partneritet publiko privat, është e mire është koherente faza dytë me hap kompani tonën publike, e cila faktikisht donë kosto, donë bord, donë pagesë dhe nuk mundemi momentalisht me pas kompani ne, dhe faza e tretë me stacion të autobusëve të Gjilanit me bë marrëveshje me funksionalizuar, mi punësua 6 punëtorë, me qenë një rregull dhe me pas mirëmbajtje. Kryetare e ka për detyrë me bë propozimin, nëse ai nuk kalon del një tjetër. Hajde, le të propozon kuvendi e nisim tjetrin. The rrugën se lanë, e nalin, a ke mundësi të me tregosh kush nuk e len shtetin me punua, çfarë fjalori është ky, po të tregoj se ligji është mbi individin, nëse ne p.sh.: e arsyetojmë individin me sjellje jo institucionale në rrugë tjera, nuk bajna mirë, nuk është mire me dezinformua opinionin as nuk ka qenë 600 mijë euro, as nuk ka qenë ka po thua ti me I ra, është memorandum I nënshkruar me ministrin, me datë, I protokolluar, e ka shumë e caktuar. Tash ministri aktual e ka shkurtua buxhetin prej 500 mijë euro në 300 mijë euro, me 286 mijë euro na I kanë lanë për atë rrugë, mirëpo ai ka pas projekt me këto pare, tash 2 segmente janë kryer, individin nuk mundet me pengua, janë çështjet institucionale, procedural dhe rregullativ dhe shkon kjo punë. E ke përmend edhe rrugën Drobesh – Mugillë, shiko emërtimet e kodeve, është mirë mi pa projektet, nuk banë me ba predikime, se masandej të vjen keq pse fola. Fabrika e tekstilit, shiko, unë edhe sot kam pasur takim me investitor hungares për fabrikën e tekstilit, na edhe me Luksenburgun kemi hap repart të rrobaqepësisë, na jemi të interesuar me prua investime, po investitorët nuk I kemi pru na në komunë, I kemi prua te partnerët e tyre në segmentin privat, na nuk kemi ndërhyer kurrë, na duhet me qenë në përpjekje të vende të punës, edhe te fabrika e djathit, edhe te tekstili, edhe te zona ekonomike, duhet me qenë krejt bashkë, nuk dhezë një variant dhezë e dyta. Nëse I kanë prish raportet me partnerin, nuk donë me thane që I prishin me tjetrin. Përpjekjet tona janë maksimale me pru investitor. Shërbimet publike, menaxhimi, aty unë mendoj se është ka punohet shumë, kurrë nuk është punuar ma shumë. Pajtohem me këshilltarin e fundit, se tha, duhet me krijuar ende kushte, sepse I kemi rritur parametrat. Te Drejtoria e Arsimit, nuk mundem me u pajtu me ty Bekim qysh e paraqet ti si profesor, si e paraqet ti drejtorinë kësisoj, a shitesh kishe s'po e dinë, a me çfarë udhëzime administrative dalin konkurset, pranohen punëtorët, çfarë kritere kanë etj. Në konkurs marrin pjesë një prej shkolle, një prej ministrisë, nja prej drejtorisë, ti nuk mundesh me paraqitë

kësi dezinformoftë. U përmend edhe për bursa, ju kam lutë unë, I kam lut organizatat dhe prapë I lus që me marr pjesë në konkurse, që me qenë ma transparent, se studentet janë të njëjtë për neve krejt. Edhe për media, ju dy tre vetë po thuani, 6 muaj nuk kanë marrë pjesë, kush I ka ndal mediat me marr pjesë këtu, kryetari. Rasim, stadium I Pozheranit nuk I ka pas fajet asnjëra, problem ka qenë te Ministria e Kulturës te një kod. Gjithë vitin menxi tash që e kemi zhbllokuar. Për zhveshtore kemi punuar me të hyrat vetanake, tash do të punohen edhe punët të tjera në stadiumin e Pozheranit. Te “Lagjja Muhagjerve”, fushën sportive këtë vit e kemi paraparë rregullimin e tribunave edhe në fushën e shkollës fillore “Halil Alidema”, edhe rrethojën. Për vitin e ardhshëm do të shikojmë bashkë të planifikojmë. Sa I përket dobive me Komunën e Kirchimit, janë vendime botërore për pushtet lokale, për strategjinë 2020 -2030. Aty hynë strategjitë lokale zhvillimore, ekonomike, aspekti edhe klimatik edhe ambiental, edhe shumë të tjera. Na një projekt të vogël e kemi përfituar, jemi duke e implementuar në Smirë, sa do I vogël që është tjetrin jemi duke e pritur, se kemi konkurruar, na nuk do të jemi në vitin 2030 por Viti përfiton besojmë shumë, se edhe me austriakët do të jemi shumë shpjetë. Taulant, me respekt, ti ke ba pyetje, të kanë ardhur disa përgjigje, nuk je I kënaqur, të vinë edhe tjerat. Sa I përket te ura, miqësisht po ta them, por edhe zyrtarisht si kryetar komune, se po me vjen mua shtrembët po me vjen, se urën afër saj të djegtë në skej nuk e kemi përmend asnjë, as çka u ba, as ku na mbeten paret, sa pare na shkuan aty, pa u rregulluar ura hiq janë shkaur 215 mijë euro. Sa ka kushtuar, tash dëgjo, saktë 300 mijë ka qenë fondi I ndarë nga Ministria e Infrastrukturës, përfituesi është 213 mijë euro. Ky është komplet projekt I Ministrisë së Infrastrukturës. Njazi, ke ngritë shumë çështje, është e drejtë e jotja, I ke përmend pagat jubilarë, I ke përmend kontratat kolektive. Ti e dinë, se këto telashe na I ka lan niveli qendror, kontrata kolektive naj rritke për 30 mijë euro harxhimet e komunës. Ai nuk ishte faji im, masi është nënshkruar. Unë jam për, por a duhet me naj qit paret neve se edhe nuk banë me than ndryshe, mirëpo paret u dashtë me na i qitë. Tash, edhe këta që kanë komplimentu për raportin, edhe për punën, unë i falënderoj. Për plan të veprimit ishte një pyetje, të njoftoj Njazi, se për plan të veprimit jemi duke punuar me USAID-in, me një projekt të veçantë për zbatimin e rekomandimeve të auditorit gjeneral edhe auditorit të brendshëm. Unë bashkëpunoj ngushtë me auditorin e brendshëm. Raporti voluminoz, por edhe për një qeveri komunale që ka punuar një vit rresht, për mua nuk është raport voluminoz, ka hala aktivitete që shumë nuk I kemi paraqitur, po ju them një të vërtetë, se është punuar 7 ditë në javë. Ujërat e zeza që vinë nga Sllatina janë problematike që na brengosin krejtëve edhe prej Zllatari edhe prej Komogllave, je duke e ngritur Remzi qe dy tri here, me të drejtë unë kam kërkuar nga kryetari I Ferizajt, që këtë çështje me rregullua. Te pyllëzimi, ne po punojmë që edhe këtë vit brezin kodrinor me pyllëzu, nuk kanë qenë pak 20 hektar. Te drunjtë e konfiskuar, po përmenden shpesh, mos harroni se tregu I rregullon senet, vetëm një e di, që prej se kemi ardhur, asnjëherë nuk I kemi blerë drunjtë ma shtrenjtë se që I kemi shitur. Sameti ka ngritur disa çështje me të drejtë, janë çështje edhe profesionale, duhet me u shikua në realizimin e planit të secilës zyre. Jam angazhuar shumë, se di a e dini, ja kemi bërë edhe plan të kryetarit të komunës. Ndoshta jemi e vetmja komunë në Kosovë që kemi plan të punës së kryetarit, plan të punës kanë gjitha drejtoritë, Zyra Prokurimit, Zyra e Auditimit, realizimi I planit të punës, natyrisht se kërkohet, sa di unë realizimi është I kënaqshëm, moment si të lëshohet buxheti, ne kemi me shkuar me bursa për studentë. Reparti I gjinekologjisë është cekur. Na kemi pas gjinekolog, e kena repartin, i kemi punëtorët, ka shkuar në pension doktori nga Smira, tash neve ne pret me zavëndësu me procedura të rregullta dhe me pas profesionalistin në repart.

Brenda mundësie jam munduar me ju përgjigj në pyetje shumicës, duke ju falënderuar gjithëve për konstruktivitet. Për pyetje qa kemi mbetur diçka, e keni derën qel, do të mundohem edhe mbas andej me ju përgjigj secilit veç e veç. Unë ju falënderoj për bashkëpunimin për vitin 2018. Uroj që edhe këtë vit na me punuar bashkë dhe ju dëshiroj suksese dhe ju lus që me më ndihmuar, për shkak se një pjesë jeni opozitë në Viti, por jeni pozitë në nivelin qendror. Ju kërkoi bashkëpunim në të mirë të qytetareve të Vitisë.

**z.Bekim Azizi;** Besimi që e livdoj, të ju tregoj, se është edhe këshilltar I kryetarit. Ai merr edhe një rrogë prej kryetarit si këshilltar I tij, ai duhet me livdu se paguhet për të. Më tha dezinformova për rrugën që po shkruan këtu Drobesh-Mugillë. Qetu në raport kryetar, ma ke pru zgjerimi I rrugës Drobesh –Mugillë, unë nuk dezinformova, ashtu po shkrun. Tha ka ekspolodu Shoqata e gjahtarëve në kohen e PDK-së, edhe naj kan marr

12 mijë euro që është lënduar, por nëse ke deshmi që e ka eksploduar PDK-ja, qoje në gjykatë. Më tha dezinformova për konkurse, unë nuk e përmenda konkursin, unë ti lexova kriteret 8 pikë me ja dhanë drejtorin, për diplomë edhe 100 pikë me ja dhanë për testë me gojë aty e kalojnë me the nuk kalojnë prej petkut politik un pot ë kallxoj që qe sa je ti kryetar nuk e ke marr asnjë të PDK-së vetëm nese ke bërë Pazar me najkanë se kush në punë nuk ka hy, te raporti I auditimit kryetar që the veq në komitet na raporton kë KPF e bjen vetem planin e punës un kam kërkuar që sa kohë me na I sjell raportin e punës nukna I keni sjell se kan than nuk ban me pru kam kërkuar për kuvend 2 seanca ma kanë pruar me shkrim një arsytim që jo me pru raportin që qa ka ba gjetje auditori .

**Kryetari I Komunës z. Sokol Haliti;** Mos më detyro me ti përmend me emra sa kemi marrë, qe një po e përmendi, e ke strukturë, djalin e Beshir Pirës, çka është ai, ka qenë strukturë kur e kemi pranuar në punë. Moment se jam ardhur unë ka përfunduar çështja e diferencimit në vitin 2014, asnjë nuk e kam larguar unë prej punës, vetëm po të them se kjo nuk qëndron qa po thua ti.

**Znj.Mirlinda Sadiku:** Sinqerisht kryetar, do të kisha pas qef ma së pari që këtë vend ku po punojmë, ku po I kryem punët e kuvendit me rregulluar e leje ma me investu tjera kah, na u mërdhimë këtu. Gjithëherë mbaj përgjegjësi për fjalët publike që I them. Jo ma larg se dje e kam konfirmuar informatën me znj.Hanife Januzin, nëse nuk gaboj kam vetë, keni majtë seancë të jashtëzakonshme për me përkrah këtë qendrën strehimore për gratë të cilat pësojnë dhunë në familje. Më ka thanë njëherë na kanë dhanë po nuk jam e sigurt a është viti 2014, ma nuk na kanë ndihmu. Jemi të detyruar që mos t'i pranojmë viktimat e dhunës në familje, pikërisht që nuk keni dhanë para për këtë qendër, prandaj kjo është informatë e konfirmuar edhe nga kjo drejtoreshë, prandaj na në seancën e jashtëzakonshme, gjitha subjektet politike kemi nënshkruar një deklaratë edhe kemi ra në pajtueshmëri, që të ndihmohet dhe të participohet. E ceka, 41 raste në familje, zonja e nderuar thotë, se ne nuk mund të mbajmë nëse nuk participojmë, se ne varemi nga këto donacione që jepen. Sa I përket konkursit, unë e kam shikuar konkursin që e shpall DKA, në cilat ligje bazohet, aty shumë mire thotë, neni 35, paragrafi 1 dhe 5, ku përzgjidhen edhe profesorët edhe drejtorët edhe zavendësdrejtorat. E para është arsimimi, e dyta është përvoja, e treta kualifikimi. Nuk jemi tu fol pa arsye, nuk jemi tu fol pa shkas. Sa I përket qasjes në dokumentat zyrtare mua mu ka refuzua arsyeshmëria që mu ka dhanë nuk ka qenë arsye për me besua për arsye, nenin, ligjin, paragrafin, në cilin janë thirr, e kam verifikua edhe në ligjin e ri edhe në ligjin e vjetër. Askund nuk referohet ajo pikë, unë kam komunikuar me zotërinë në KARITAS, ai më ka thanë se gjitha dokumentet janë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në komunën tuaj, atëherë pse mos me mu lejua qasja. Kam pas dëshirë se ka pas njerëz të cilët janë ankuar që nuk janë paguar në bazë të asaj kontrate. Për atë arsye më ka interesuar se nuk është e imja personale, si dhe isha nderlidhë te shkollat. Unë në asnjë diskutim nuk jam politik, në shkollë përkundrazi, ju jeni njoftuar me rastin dhe po ashtu mua mu ka ba presion, pse kam kritikuar edhe pse kam kërkuar kushte ma të mira në shkollë. E dini shumë mirë rastin për çka po I referohem. E dinë edhe drejtoresha, se imelli ka shku edhe përmes zyrës së saj dhe aty nuk ka pas të vërtetë, por jam keqinterpretuar edhe të jesh I bindur se drejtorët janë politik.

**z.Njazi Isaku:** Unë dua me u lidhë me tri çështje. Çështja e parë, çështja e incizimeve të mbledhjeve. Këta e dinë, është udhëzimi administrativ, si rregullohet kjo. Nuk ka nevojë ndoshta na me ba ritenderim, me qit çështjen e mediave, kur dihet me Udhëzim administrative si rregullohet çështja e një kamere dhe kaq dhe teleprezenca. Na kemi pyet edhe një mbledhje të caktuar, kanë thanë se është mungesë e stafit. Po u dashtë me qu dikan në trajnime edhe s'ka pas nevojë na me lujtë kështu na çdo muaj këtë debat. Te çështja e autobusëve, po dua mu lidh, ajo është ndërmarrje 100 përqind e Komunës së Vitisë me Ligjin për Ndërmarrje Publike, se e njoh këtë fushë. Na si votë kemi qenë kundër, për arsye se duhet me bë njëherë një plan fillimisht, se qysh me funksionalizuar atë Vitia, duhet me pas një kosto, sa mundet me pas fitim edhe qysh rregullohet me aksionar, me bord të drejtoreshave. Besoj që fillimisht komuna mund me nda mjete të caktuara, se ka të drejtë ligjore me nda një shumë të caktuar, për me funksionalizuar stacionin e autobusëve, por jo me ja dhanë Gjilanit, kur ti mund vet. Mendoj se vetëm I duhet një analizë të fshatrave, edhe sa pare mund me I mbledh, kur e ke këtë analizë edhe e qetë këtu në Kuvend Komunal, ku në të njëjtën kohë janë aksionar që është komuna. Ti ke të drejtë me ndahë



fond të caktuar për këtë çështje për me rifunksionalizuar stacionin e autobusëve në Viti. Për çështjen e prokurimit, na krejt qa kemi kërkuar le të bëhen publike. Krejt ato kontrata, kjo është transparent, kanë filluar prej tetorit. Çështjen e auditorit të brendshëm, na si opozitë pajtohemi se nëse nuk është ligjore me dal në kuvend, por së paku ato rekomandime, a është duke u zbatuar procedura?

**z.Taulant Haxhiu:** Për 219 mijë euro sa ka kushtuar ura, kërkoj prej z.Ramiqit, të ma jep si informatë kryetar. Unë po e shohë, se çdo herë kur po del në foltore po e përmend qeverinë e PDK-së. Ajo ka pas pushtet 6-vjeçar, 2 plus 4. Ti 5 vite gati 6, një projekt që ka qenë dyvjeçar I kanalizimit, që ka pas PDK-ja, ti ke mund me vazhdu atë punë. Unë nuk e di që në Komunën e Vitisë u bë diçka ma shumë nga pushteti Haliti. Unë e di një, që Sokol Haliti ma të zhvilluarën në Kosovë e ka marketingun edhe propagandën. z.Haliti një pishë me mbjell e bënë marketingun si me zbulua një minierë edhe për atë I ka marrë 52 përqind. Unë nuk e di në këtë komunë, përveç kozmetikës që është bërë, nuk e di që është bërë diçka e madhe. Stacioni I autobusëve sa ka kushtu e kisha bërë vetë me të hyra të mija vetanake. Nuk e di që ke bë diçka madhore, po unë veç një të vlerësoj, se propagandën e ke në mënyrën ma të mire të zhvilluar, a nuk e di që ke bë diçka ma shumë se qeverisja e Nexhmedin Arifit.

**z.Afrim Ramushi:** Nuk desha me dal ma herët, por më nxiten parafolësit. Është punuar aq shumë, unë e përgëzoj kryetarin dhe I uroj shëndet. Çdo kund ku punohet ka edhe vërejtje, ka edhe të meta, por po ju them, se nuk është vetëm zi siç o e shiheni ju. Drejtori I Shërbimeve Publike e ka bë punën ma të mire të mundshme, edhe në qytetet ma të mëdha të Evropës, kur ka vërshime dhe reshje, ka pengesa, kurse te na kanë qenë shumë në nivel rrugët. Në shëndetësi, unë e kam familjen në Zvicër, edhe në Zhenevë kanë problem kur shkojnë në emergjencë.

**znj. Fatbardha Emini:** Desha vetëm një dilemë që është ngritur këtu. Po konsideroj se është shumë e padrejtë për shkak se qe 20 vite ma transparent konkurset në drejtorin e DKA- së nuk ka pasur. Pata dëshirë që me qenë edhe Mirlinda këtu, se është duke spekuluar dhe po më vjen shumë keq kur kjo bëhet prej këshilltareve që vinë nga fusha e arsimit, kur e dinë që në sektorin e arsimit rekrutimi i personelit arsimor nga shtatori bëhet përmes dy Udhëzimeve administrative. 8 pika se po thua Bekim, nuk e kemi shpikur na Udhëzimi administrative mbi normativin, I klasifikon kështu; studimet master o kanë 15 pikë, 10 pikë sistemi I vjetër 4-vjeçar dhe 8 pikë baqellor katërvjeçar janë këto tri kategori, që Udhëzimi administrative mbi normativin I ka bërë të barasvlershme. Pastaj vjen intervista me shkrim, që është 100 pikë dhe intervista me gojë që është 100 pikë në udhëzim. Nuk poentohet përvoja e punës, po në bazë Udhëzimit parauniversitar kemi dashtë me shti, kur një kandidat është I barabartë me tjetrin me marr një poentim, përvoja e punës.

**z.Nexhmedin Jakupi:** U bënë disa pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Shumica ishin shqetësime rreth pastrimit të rrugëve. U përgjigj edhe kryetari, por po e njoftoj Njaziun, se na si drejtori e kemi një plan sidomos për sezonën e dimrit, që e zbatojmë varësisht edhe prej mundësive buxhetore që I kemi. Është me rendësi me ditë, se drejtoria gjatë sezonës së dimrit ka obligim t'i pastroj nga bora gjitha rrugët kryesore, sepse nuk kemi mundësi rrugicat t'i pastrojmë, se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm. Ky projekt e ka menaxherin e vetë, I cili e menaxhon kontratën, plus e kemi edhe komisionin I cili pranon punët në teren gjatë operimit të kompanisë. Po e shfrytëzoj rastin me I përgëzua zyrtarët e drejtorisë sime, që gjatë këtij sezoni të dimrit kanë mbetur edhe pa gjumë, duke I përcjellë punët e kompanisë. Një njoftim, po e bëj vetëm një intervenim në fshatin Debellde. Neve na kushton diku 500 euro, ndërsa sa I përket çështjes së ujësjellësit në Pozheran, përgjegjësi është ekskluzive kompanisë regjionale "Hidro Morava". Na do të bisedojmë për këtë. U ngritën disa çështje sa I përket faturimit, do të bisedoj me përgjegjësin e njësitit këtu në Viti.

**z.Basri Aliu:** Në drejtorinë e Shëndetësisë, u ngriten disa shqetësime, po kenë edhe disa pyetje. Unë do të mundohem edhe se një pjesë e sqaroi edhe kryetari dhe doktoresha Gjylë. Stafin shëndetësor unë e përgëzoj për punën që e kryen me kapacitetet që I kemi dhe nuk është e vërtetë që një mjek brenda një orari të punës I kryen 150 kontrole, nuk qëndron ajo, se thatë një mjek punon kujdestari në Komunën e Vitisë, por janë dy mjekë edhe në Pozheran edhe në Viti. Në Bazë të situatës, kur kemi ngarkesa të mëdha, na I kemi bërë edhe dy mjekë edhe në emergjencën e Vitisë, ndërsa sa I përket Bekimit, po të themë se nuk e paske shikuar mire raportin, se ky raport është për vitin 2018, kur është reparti I gjinekologjisë. Janë kryer 989 vizita, d.m.th gjinekologji I ka kryer. Edhe te rëntgeni, që e ka lanë, ka gjet ma mirë pozicion, edhe aty janë kryer 1126 fotografime. Ishte edhe

çështja e bagremave që janë pre drunjet, por unë po I tregoj Remziut, që aty kanë qenë do bagrema, mundesh me I vërtetu edhe ti vet, që kanë qenë aq të dëmshëm, sa që therrat e tyre kanë qenë aq të mëdha. Na kemi marr leje për të dhe I kemi zëvendësuar ato.

**z.Skender Ahmeti:** Janë do pyetje që janë bërë në pikëm e par të rendit të ditës, por për shkak se kishmi raportin, nuk e dhamë përgjigjen. Atëherë, dr Gjylë ka bërë një pyetje që ka qenë me rendësi, për një kërkesë për çerdhe. Në raportin 6-mujor ka qenë në shqyrtim e sipër, ndërsa në raportin vjetorë është refuzuar, për shkak se ka qenë një kërkesë për hapjen e një çerdhe private për fëmijë, ka qenë kërkesë e deputetit të nivelit qendror, Sali Saliut dhe kur ka shkua inspektoriat me pranua teknikisht lokaln, nuk I ka plotësua të gjitha kriteret. I kemi dhanë afat që të përmirësohet, por si duket ai ka heqë dorë për hapjen e këtij biznesi dhe na u dashtë me bë refuzimin e asaj kërkesë brenda afatit ligjor. Pyetja dytë, ka qenë për Blerina Lubishtanin, që ka pyetur për asgjësimin e rreth 22500 kg mallrave ushqimore, që janë asgjësuar brenda vitit 2018. Është një shumë e konsiderueshme e artikujve ushqimor, të cilat nuk I kanë plotësuar kushtet për konsum tek kompania “Higjiena”, ndërsa artikujt tjerë që kanë qenë me specifika të veçanta, siç janë produktet e mishit, janë eliminuar në mënyrë profesionale nga një kompani e cila është e licencuar në nivel vendi. Remziu pyeti për raport, pyetja ishte se inspektorit nuk I takon të merret me konstatime, ndërsa të tjerat punë që I ka bërë nuk I përmendi, sigurisht të mirat nuk po I përmendni ju opozita, por unë po të them me sinqeritetin ma të plotë, se inspektori I ambientit I Komunës së Vitisë është ma I miri në nivel vendi. Kemi konstatimin e ujërave të zeza që ka konstatim të rand, gropat septike, prandaj krejt këto janë çështje që duhet të merremi ne si institucione ma të larta, jo inspektori. E përmende se pse ka intervenuar edhe në dy raste në Komunën e Klllokotit. Komuna e Klllokotit e ka dëmtuar ma së shumti Komunën e Vitisë, për shkak se e tërë komuan përkufizohet brenda Komunës së Vitisë dhe kemi hedhje të mbeturinave ne territorin e Klllokotit, dhe na ka thirrur policinë për të intervenuar, ndërsa rastin tjetër e kemi nga sperkatja me pesticide. Një banorë tjetër ka kërkuar ndihmë, zyrtarisht Komuna e Klllokotit ka kërkuar ndihmë nga inspektariati, dhe kryetari e ka një marrëveshje të mirëkuptimit me Komunën e Klllokotit, që në raste kur ata nuk janë të gatshëm me kry obligimet e veta, I ndihmojmë. Sameti e përmendi një rast te dëmtimi I sinjalistikës e kubzave të trotuareve, është një shqetësim me vend, po unë po sugjeroj, se me stacionin policor në Viti kemi bashkëpunim shumë të mire, 24 orë ju përgjigjemi stacionit policor.

**Kryetari I Komunës z.Sokol Haliti:** Unë desha me ju falënderuar për fund gjithë kuvendarët për kontributin, pavarësisht kualifikimeve për marketing a diçka tjetër. Unë po ju them, se kjo qeveri nuk është marketing, se nuk është marketing shkolla e Pozheranit, stadiumi i Pozheranit, stadiumi i Vitisë, nuk është shëtitorja marketing, nuk është ura marketing edhe shumë e shumë rrugë e punë tjera të kryera, nuk janë marketing. I nderuar, unë jam mësua me kualifikimet e tua, çdo seancë që po e banë nga një të tillë, por unë po ju them një, se kjo qeverisje nuk është marketing, por është punë dhe përkushtim. Në fund, faleminderit shumë të gjithëve.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit nr. 01-410/03-538 të datës 05.06.2018 për formimin e komiteteve konsultative**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë para juve e kame sjell këtë pikë të rendit të ditës, behet fjalë për ndryshimin e vendimit për komitetet konsultative, tek kompensimi i pagese për anëtarët e komiteteve konsultative. Duhet të jemi ne harmoni me Udhëzimin administrativ, i cili parasheh që kompensimi për anëtarët e këtyre komiteteve të jete ne vlerë prej 50 euro e jo siç e kemi pas deri me tani 50 euro. Unë hap debat për këtë pikë, a do dikush fjalën? Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjeve të takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Materialin e keni marr me kohe, nëse ka ndonjë pyetje, unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, e qes në miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika të pesë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bashkëpunimin ndërkomunal të qëndrueshme me Komunën e Kirrhain**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Materialin e keni pranuar me kohë, kryetari me herët vetëm njoftoj për këtë bashkëpunim. Unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në miratim, ku nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Draft Plani i punës për vitin 2019 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Materialin e keni pranuar me kohë, unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

**7. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për vitin 2018.**

**Kryesuesi z.Naim Pira** bënë prezantimin e kësaj pike dhe hap debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

**8. Ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Këtu kemi të bëjmë me ndryshimin e një anëtari të shoqërisë civile, i cili nuk është në Kosovë dhe nuk mundet të jetë pjesë e komisionit. Andaj, ne kërkojmë nga ju, që të bëhet ndryshim plotësimi i një anëtari të komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka të interesuar, unë qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Me kaq e përfundojmë këtë mbledhje, duke ju falënderuar për kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:20 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---